

**UDHËZIM**  
**Nr.39, datë 9.12.2008**

**PËR ADMINISTRIMIN DHE DOKUMENTIMIN E PROCEDURAVE TË PAJISJEVE FISKALE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të neneve 55 dhe 56 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dhe të paragrafëve 17, 18, dhe 23 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale”, i ndryshuar, Ministri i Financave,

**UDHËZON:**

**1.PAJISJET FISKALE QË DO TË IMPLEMENTOHEN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Implementimi i sistemit fiskal të pajisjeve fiskale përfshin këto komponentë:

**1.1 Pajisjet fiskale, ku përfshihen:**

a) Regjistruer të dhënash fiskale elektronike me memorie fiskale, të cilat janë pajisje për regjistrimin e të dhënave për vlerën e mallrave të shitura dhe shërbimeve të kryera për klientët, regjistrimin e tyre në memorien fiskale, duke siguruar në këtë mënyrë gjenerimin e raporteve të veçanta;

b) printerat fiskalë janë pajisje me memorie fiskale që mund të punojnë me çdo program aplikues, duke përdorur vetëm një ndërfaqe (driver) ekzistues;

c) sistem elektronik me memorie fiskale për regjistrimin e qarkullimit të shitjes me pakicë të derivateve të naftës nëpërmjet pajisjeve kalkuluese dhe konsumin e karburanteve të lëngshme (stacionet e naftës, të gazit etj).

**1.2 Rrjetin e komunikimit ndërmjet tatimpaguesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili përfshin:**

a) Rrjeti Valor Celular

i) Rrjeti GPRS

ii) Rrjeti GSM

b) Rrjeti Ethernet

c) Çdo lloj tjetër rrjeti komunikimi

Protokolli i transmetimit të të dhënave në rrjetin e komunikimit ndërmjet tatimpaguesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve duhet të bazohet mbi protokollin TCP/IP.

Transmetimi i të dhënave mujore të xhiros në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve është detyrim ligjor i tatimpaguesit dhe duhet të realizohet brenda datës 10 të muajit pasardhës.

Përdorimi i rrjetit GPRS për të lidhur pajisjen fiskale të tatimpaguesit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve është i detyrueshëm. Për rastet kur tatimpaguesi ose shoqëria e autorizuar kërkon përdorimin e ndonjë rrjeti tjetër, ai duhet të paraqesë me shkrim kërkesën pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të marrë miratimin paraprak të saj.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve hyn në marrëveshje kontraktuale bashkëpunimi me operatorët e telefonisë celulare për sigurimin e shërbimit GPRS.

**1.3 Sistemin e integruar kompjuterik:**

a) Për ruajtjen e deklarimeve periodike të pajisjeve fiskale;

b) Përpunimin e deklarimeve periodike të pajisjeve fiskale nga ekspertët tatimore;

c) Menaxhimin e informacionit nga shoqëritë e autorizuara.

**2. REGJISTRUESI ELEKTRONIK FISKAL, PËRKUFIZIMI TEORIK, FORMA, FUNKSIONI**  
Regjistruesi elektronik fiskal është një pajisje me memorie fiskale dhe qark shiriti kontrolli në të cilat regjistrohen të dhënat për vlerën e mallrave të shitura dhe shërbimeve të kryera për klientët, duke siguruar në këtë mënyrë gjenerimin e raporteve të veçanta. Tatimpaguesit, të cilët shesin mallra, prodhime, apo kryejnë furnizime të shërbimeve në lokale apo njësi të hapura për publikun, janë të detyruar të përdorin pajisje fiskale për regjistruar dhe certifikuar shitjen dhe të lëshojnë, në mënyrë të detyrueshme, kuponin tatimor. Regjistruesi elektronik ka si qëllim të certifikojë dhe regjistrojë shitjet duke përdorur një mekanizëm për regjistrimin e qarkullimit i cili duhet të jetë i mbrojtur. Të dhënat duhet të regjistrohen në mënyrë të njëkohshme në një njësi memorie që quhet memoria fiskale e cila duhet të jetë e izoluar dhe e bllokuar me rrëshirë në brendësi të regjistruesit elektronik dhe në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik.

Këto të dhëna regjistruesi elektronik duhet t'i dërgojë periodikisht përmes një protokollit të brendshëm të programuar në programin logjik hardware të tij dhe një infrastrukturë rrjeti të realizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Regjistruesi elektronik, përmes të cilit memorizohet qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve, ka këto karakteristika:

Ka një program logjik hardware në gjuhën shqipe, i cili ndërtohet ekskluzivisht sipas kërkesave të këtij udhëzimi, të realizuar si një modul fiskal i pavarur, i mbrojtur nga ndryshimi dhe fshirja, duke përdorur funksionet standarde për regjistrimin e shifrave të mallrave e shërbimeve, printimin, paraqitjen dhe administrimin e të dhënave, të hyra në një memorie fiskale, siguron qartësinë, vërtetësinë dhe mos mohimin e kuponëve të lëshuar për certifikimin e shitjes përfshirë edhe atë të kthimit mbrapsht të mallit, dhe mënyrat e pagesave relative (Para në dorë (Cash), pezull, kartë krediti, çek bankar etj.). gjithashtu lëshon kuponë përmbledhës për këto veprime, raportet tatimore ditore të lidhur reciprokisht me transmetimin e raporteve tatimore periodike. Programi logjik duhet të jetë i ndërtuar në mënyrë që regjistruesi elektronik të veprojë në pesë regjime: regjistrim (R), lexim (X), mbyllje (Z), programim (P), si dhe regjimi i trajnimit (T), përmes të cilave kryhen.

Regjimi i regjistrimit:

a) siguron regjistrimin e qarkullimit dhe e certifikon atë mbi një letër shirit që i jepet klientit (këtu më poshtë e referuar si kupon tatimor). Ky regjistrim kryhet në mënyrë progresive për të gjithë kuponët e lëshuar që certifikojnë shitjet. Në fund të çdo kuponi tatimor printohet numri i identifikimit të pajisjes fiskale dhe logo fiskale e detyrueshme;

b) siguron regjistrimin e vlerës reale të mallrave dhe/ose shërbimeve, nëpërmjet rrumbullakimit deri në dy numra dhjetorë;

c) i regjistron në memorien e punës, bashkon dhe përmbledh të dhënat relative me kuponët e mëparshëm, në memorien fiskale. Këto të dhëna duhen të jenë të regjistruara edhe mbi qarkun e shiritit të kontrollit elektronik dhe futja e këtyre të dhënave ka kontroll logjik. Të dhënat nuk mund të jenë më të vjetra se data e prezantimit të regjistruesit elektronik, dhe të dhënat më të reja të futura nuk mund të jenë më të vjetra se data, për të cilën është përgatitur raporti periodik;

ç) siguron ruajtjen e të dhënave të regjistruara në memorien fiskale dhe regjistrimin e tyre në shiritin e kontrollit elektronik. Regjimi i leximit (X) Siguron leximin dhe printimin e të dhënave të regjistruara në memorien fiskale nëpërmjet tastierës:

a) siguron leximin statistikor të qarkullimit ditor të regjistruar dhe e paraqet atë në forma të ndryshme raporti përmbledhës apo të detajuar;

b) siguron leximin statistikor të qarkullimit në përputhje me njësitë e standardeve kohore ditë, muaj dhe vit;

c) të gjitha raportet e printuara në këtë pozicion kanë efekte statistikore jotatimore. Në kokën e çdo raporti në këtë pozicion duhet të shënohet emri i tipit të raportit dhe sigla e regjimit të leximit (X), dhe të printuar në fillim dhe në fund të kuponit sigla në bold "RAPORT

JOTATIMOR”. Këto kuponë regjistrohen në numërorin progresiv të kuponëve jotatimore dhe detyrimisht duhet të regjistrohen në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik.

Regjimi i mbylljes (Z):

a) kryhet mbyllja fiskale e qarkullimit ditor dhe printimi i raportit tatimor ditor të lidhur reciprokisht me transmetimin e raporteve tatimore periodike;

b) siguron leximin e memories fiskale përmes raporteve tatimore periodike në përputhje me njësitë e standardeve kohore ditë, muaj dhe vit mbi fluksin e shitjeve dhe analizat statistikore për aktivitetin tregtar;

c) siguron kushte për kryerjen e provës përmes vulës së kontrollit që printohet në çdo raport tatimor ditor për arsye të kontrollit të saktësisë së regjistruarit elektronik të memories fiskale dhe qarkut të shiritit të kontrollit elektronik, si dhe të funksionit në lidhje me të.

Raportet tatimore-ditore apo periodike karakterizohen nga titulli i raportit i shoqëruar nga sigla (Z) dhe në fund të kuponit printohet logo fiskale dhe sigla në bold “RAPORT TATIMOR”.

Regjimi i programimit (P)

Në këtë regjim në pajisjen fiskale mund të:

a) Regjistrohen të dhënat e tatimpaguesit, të cilat duhen të shfaqen në kuponin tatimor (emri, adresa e vendndodhjes së biznesit, numri i Nipt-it të tatimpaguesit. Për këtë funksion programi logjik duhet të regjistrojë në memorien fiskale të paktën pesë rreshta me emërtimin e tatimpaguesit (1 emri i tatimpaguesit, 3 adresa, 1 Nipti). Ndalon ndryshimin e emërtimit të tatimpaguesit deri në kryerjen e raportit-tatimor ditor dhe ndryshimet e bëra i regjistron në memorien fiskale dhe në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik me një numëror të veçantë për emërtimet;

b) Të programojë shkallët tatimore. Ky funksion është i mundur në momentin e instalimit ose vetëm pasi të jetë kryer mbyllja e raportit tatimor-ditor dhe kryen paraqitjen e hollësishme të shkallëve tatimore, të shënuar me gjerat A-I, shkalla e taksës. Me A nënkuptohet shkalla tatimore e përjashtuar, ndërsa me gjerat B-I format e ndryshme të shkallës tatimore të parashikuar me ligj. Ndryshimi i një shkalle tatimore mund të kryhet vetëm pasi kryhet raporti tatimor-ditor dhe ndryshimet e bëra regjistrohen në memorien fiskale dhe në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik me një numëror të veçantë për ndryshimet e shkallës tatimore.

c) Të administrojë

- Artikujt:

- kodi i artikullit;

- emërtimet e mallrave apo shërbimeve;

- çmimi 1, çmimi 2, çmimi 3;

- reparti përkatës sipas shkallës tatimore; Grupimin e shitjes me reparte:

- uljet;

- mënyrat e pagesës;

- valutat e huaja;

- administron grafikët ( logon e tatimpaguesit për ta vendosur në kuponin tatimor);

- administron portat seriale të pajisjes fiskale për programimin e tyre për t'u lidhur me pajisje shtesë, të tilla: si bar-kod, skaner, peshore, terminal për pagesën nëpërmjet kartave të kreditit etj;

ç) Të programojë parametrat e komunikimit me rrjetin e komunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për transmetimin e raporteve tatimore periodike. Transmetimi i të dhënave duhet të bëhet minimalisht një herë në muaj;

d) Programimi i datës dhe orës. Programi logjik ndalon ndryshimin dhe kthimin e datës, nëse janë kryer regjistrime në memorien fiskale. Lejon programimin e orës legale brenda kufirit të vetëm +/- një orë, vetëm pasi kryhet mbyllja e raportit tatimor-ditor;

dh) Të kryejë kontrollin dhe leximin e memories fiskale dhe qarkut të shiritit të kontrollit elektronik.

#### Regjimi i trajnimit

Programi logjik lejon procesin e trajnimit me të gjitha funksionet e regjistruarit elektronik fiskal. Ky veprim është i mundur vetëm pasi është kryer raporti tatimor dhe vetëm nëse makina është e fiskalizuar. Në këtë fazë gjithë hapësirat në kuponët e lëshuar duhet të mbushen nga simboli “?” dhe në kokën e kuponit siglën “INFO JOTATIMORE”. Në shembujt grafikë të kuponëve do të paraqiten edhe kuponët e lëshuar në këtë regjim.

#### 2.1 Forma dhe paraqitja e regjistruarit elektronik fiskal

Karkasa e pajisjes fiskale duhet të jetë e izoluar dhe vetëm me një pozicion për ta hapur atë. Në këtë pikë vendoset vula fiskale mbi të cilin shënohet me një goditës (puncon) që ka të sigluar shenjat e vulës së identifikimit të teknikut të autorizuar, lista e të cilëve është e depozituar nga shoqëritë e autorizuar me numrat përkatës të identifikimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Pajisja ka të ekspozuar në pamjen e dukshme të klientit, etiketën e identifikimit sipas kriterëve të paraqitura më poshtë

Shembull etikete identifikimi të regjistruarit elektronik fiskal dhe etiketën e kontrollit periodik pozitiv me ngjyrë jeshile të paraqitur si më poshtë:

CE ROHS	Shoqëria e autorizuar	
	Modeli	
	Numri i identifikimit	
Tensioni 230 V	Numri i autorizimit	
	Numri i certifikimit të DPM	
	Data e certifikimit të DPM	



- Forma: katrore
- Dimensioni i brinjëve: > 40 mm
- Ngjyra: fusha jeshile me germa të mëdha të zeza.
- Poshtë shkrimit REGJISTRUESI ELEKTRONIK FISKAL shkruhet numri i identifikimit të regjistruarit.
- Në pozicionin e shënuar si \_\_\_\_\_ shkruhet viti i skadencës.
- Në eklips vendoset vula fiskale që identifikon shoqërinë dhe teknikun që është ngarkuar për kryerjen e kontrollit periodik.
- Materiali: Adesiv që nuk lejon të hiqet dhe shkatërrohet me provën për ta hequr.

Në rastet kur regjistruesi elektronik nuk e ka kaluar kontrollin periodik (apo është refuzuar) në pamjen e dukshme të publikut, tekniku i autorizuar duhet ta ketë të vendosur etiketën e kontrollit periodik negativ të paraqitur si më poshtë:



- Forma: katrore
- Dimensioni i brinjëve: > 40 mm
- Ngjyra: fusha e kuqe me germa të mëdha të zeza, e vijëzuar nga një diagonale
- Germat: bold, lartësia 5 mm
- Poshtë shkrimit REGJISTRUESI ELEKTRONIK FISKAL shkruhet numri i identifikimit të regjistruesit poshtë shkrimit NUK FUNKSIONON dhe në logotipin e paraprintuar nga laboratorit vendoset vula fiskale që identifikon shoqërinë dhe teknikun që është ngarkuar për kryerjen e kontrollit periodik.

- Materiali: Adesiv që nuk lejon të hiqet dhe shkatërrohet me provën për ta hequr.

Pajisja fiskale është e shoqëruar gjithmonë me librin e mirëmbajtjes në të cilën regjistrohen të gjitha veprimet e kryera me regjistruesin elektronik fiskal. Në faqen e fundit të librit fiskal duhet të jetë e printuar dhe firmosur nga administratorët e shoqërive të autorizuara deklarata e përputhjes teknike dhe funksionale të regjistruesve elektronik fiskal që këto shoqëri do të shesin me karakteristikat teknike dhe funksionale të modelit të certifikuar nga Drejtoria e Metrologjisë dhe Kalibrimit.

## 2.2 Memoria fiskale

Kapaciteti i memories fiskale siguron ruajtjen e regjistrimeve për:

- 1800 raporte tatimore-ditore;
  - 20 ndryshimeve të shkallëve tatimore;
  - 200 ndërhyrjeve për zhbllokime të softwareve;
- këto regjistrohen në numërorët përkatës dhe janë të paraqitur në çdo raport tatimor-ditor si:
- numërori i raporteve tatimore-ditore;
  - numërori i ndryshimit të shkallës tatimore;
  - numërori i ndërhyrjeve teknike;

gjithashtu në memorien fiskale regjistrohen në numërorë të veçantë dhe paraqiten në raportin tatimor-ditor edhe:

- numërori i kuponëve tatimorë të ditës, i cili me mbylljen ditore bëhet zero;
- numërori për totalet e kuponëve tatimor të lëshuar për të gjithë periudhën;
- numërori i kuponëve jotatimor

## 2.3 Të dhënat e printuara

Pajisja fiskale regjistron dhe certifikon shitjet dhe këtë e regjistron në të njëjtën kohë si në memorien fiskale, por edhe në qarkun e shiritit i cili vërteton dhe nuk lejon ndryshimet e informacionit në memorien fiskale. Të dhënat e printuara mbi kuponin tatimor duhet të jenë identike me të dhënat mbi shiritin e kontrollit. Shiriti i kontrollit është i zbatuar në formë kujtese elektronike dhe emërtohet si qarku i shiritit të kontrollit elektronik ose shkurt QSHKE.

Qarqet e Shirimit të kontrollit duhet të kenë një etiketë sipër mbi të cilën shkruhet numri progresiv i tyre. Programi logjik i regjistruesit duhet të sigurojë bllokimin e regjistruesit nëse hiqet qarku i shiritit të kontrollit elektronik apo të zëvendësohet me qarkun e ndonjë pajisjeje tjetër apo kur është i virgjër të mos lejojë regjistrimin e qarkullimit pa e inicializuar atë. Ky qark duhet të njihet vetëm nga regjistruesi elektronik fiskal mbi të cilin është kryer inicializimi

fillestar i tij dhe pasi mbushet plot ruhet dhe për së paku 5 (pesë) vjet. Përdorimi i qarkut të mbushur kryhet vetëm për efekte kontrolli dhe statistikore. Tregimi i të dhënave mbi shiritin e kontrollit dhe në memorien fiskale nuk duhet të bëhet nëpërmjet përdorimit të shkurtimeve të kodifikuara.

Shembull i etiketës mbi QSHKE:

QSHKE nr. _____
Modeli i kasës _____
Numri i identifikimit _____
Data fillimit _____ Data mbarimit _____

*Numri progresiv i QSHKE të inicializuara  
Modeli i regjistruarit elektronik fiskal  
Numri identifikimit të pajisjes fiskale ku është vendosur  
Data e fillimit dhe data e mbarimit të QSHKE*

#### 2.4 Kujtesa fiskale

Regjistruesi elektronik siguron kujdes të qartë (paralajmërim) rreth numrit të raporteve të mbetura, që mund të futen në memorien fiskale, si dhe në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik që nuk mund të jetë më pak se 50 dhe tregon numrin e mundshëm të raporteve të mbetura fiskale, pas çdo raporti fiskal të regjistruar.

Kur kujtesa fiskale është zënë (plot), regjistruesi elektronik nuk duhet të lejojë të drejtën e regjistrimit të mëtejshëm të xhiros. Zbrazja e kujtesës do të bëhet nga shoqëria e autorizuar sipas kërkesës së subjektit përdorues të pajisjes fiskale.

#### 2.5 Kuponi tatimor

##### 2.5.1 Logo fiskale, forma

Logo fiskale është shenja identifikuese që vendoset në çdo kupon tatimor që certifikon dhe regjistron shitjet në memorien fiskale dhe në qarkun e shiritit të kontrollit. Logo fiskale vendoset në të gjitha raportet tatimore-ditore.

Logo fiskale është e përbërë nga dy rreshta

1. Në rreshtin e parë shkruhet RSH (Republika e Shqipërisë);
2. Në rreshtin e dytë MF (Ministria e Financave).

Në lartësinë e dy rreshtave të logos përpara RSH dhe MF duhet të jetë stema e Republikës në variantin bardhë e zi:

Forma grafike e logos fiskale:



1. Fjalët RSH dhe MF duhet të jenë:

2. Fonti - arial

3. Formatit - bold

4. Madhësia e shkrimit e njëjtë me madhësinë e shkrimit të elementeve të tjera të kuponit tatimor;

5. Lartësia e siglës së Republikës e barabartë me lartësinë e dy rreshtave të fjalëve RSH dhe

MF;

6. Logo fiskale vendoset në fund të kuponit i pozicionuar në qendër. 2.5.2 Të dhënat e kuponit tatimor dhe prezantimi grafik i tij

Kuponi tatimor që i jepet një blerësi apo një klienti, përmban të dhënat e mëposhtme: Koka e kuponit:

a)Emrin, adresën e tatimpaguesit;

b)NIPT-in.

Të dhënat e kokës së kuponit mund të paraqiten edhe përmes logos grafike të tatimpaguesit.

Detajet e kuponit tatimor:

c)Emrin, sasinë, çmimin dhe vlerën e qarkullimit të regjistruar të mallrave dhe/ose të shërbimeve; ç) Totale e vlerës së mallrave apo shërbimeve të shitura;

d)Mënyrën e pagesës (*cash*, çek, kartë krediti etj.); dh) Shumën e TVSH-së, sipas shkallës tatimore. Këmba e kuponit tatimor:

e)Numrin e identifikimit të pajisjes fiskale;

ë) Numri i regjistruarit ( identifikon numrin në rrjet për një supermarket), emrin ose kodin e operatorit;


f) Datën dhe orën e lëshimit të kuponit;

g)Logon fiskale.

Kuponi tatimor mund të reklamohet edhe të dhëna të tjera dhe duhet të jetë i printuar në dy kopje një prej të cilave në format letre i jepet klientit, ndërsa tjetra qëndron në shiritin e kontrollit në formatin elektronik. Të dhënat e printuara mbi kuponin tatimor duhet të jenë identike me të dhënat mbi qarkun e shiritit të kontrollit. Gjerësia e kuponit tatimor apo të raporteve tatimore periodike është në varësi të formatit të letrës që përdor secili regjistruar elektronik fiskal i certifikuar për t'u instaluar në territorin e Republikës së Shqipërisë, por paraqitja grafike e kuponit dhe raportit tatimor-ditor duhet të jetë e njëjtë.

- Prezantimi i kuponit tatimor në rast se regjistruar elektronik fiskal është i lidhur me një kompjuter kur punon përmes një aplikacioni software-ik ose në rastin kur përdoruesi kryen shitje me regjistruar elektronik fiskal duke përdorur kodet e artikujve përmes funksionit PLU (Price Look Up).

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij		Koka e kuponit
	LEK	Identifikon valutën kombëtare
1 x 60,00 UJË NATYRAL	60,00 B	Përshkrimi i artikujve, sasia, çmimi për njësi dhe totale për artikull i shoqëruar nga germa që identifikon shkallën tatimore.
1x60,00 KAFFE EKSPRES	60,00 C	
NËNTOTALË	120,00	Totale parciale në pritje për mënyrat e pagesave ose valuta.
TOTALE LEK	120,00	Totale në lekë
PARA NË DORË	200,00	Mënyrat e pagesës dhe llogaritja e mbetjes
MBETJE LEKË	80,00	

VLERA PA TVSH B	50,00	Vlerat pa TVSH siaps shkallëve tatimore
20%	10,	Vlerat për shkallë tatimore
TVSH B 20%	00	
VLERA PA TVSH C	54,00	Vlera totale e shitur pa TVSH
10%	5,45	Vlera totale e TVSH së shitur
TVSH C 10%	104,55	
TOT. VL. PA TVSH	15,45	
TOTALE TVSH		
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXX		Numri i identifikimit të regjistruarit elektronik fiskal
DATA: 20/05/2008 13:11		Numri i regjistruarit elektronik (identifikimin e tij në rrjet p.sh. supermarket)
KUPONI TATIMOR Nr. 20		dhe operatori që ka shërbyer, data dhe ora, numri i kuponit tatimor
		Logo fiskale
		

Numri i identifikimit dhe logo fiskale janë shenjat dalluese që kuponi më sipër është kupon tatimor.

Kuptimi i tyre është:


Kuponi numër 20 është kupon tatimor, pasi është lëshuar nga regjistruari elektronik fiskal me numër identifikimi nga DPT "XXXXXXXXXX" dhe i instaluar në Republikën e Shqipërisë me autorizim të Ministrisë së Financave.

Çdo kupon që nuk përmban këto shenja dalluese nuk është i natyrës tatimore.

- Prezantimi i kuponit tatimor në rast se regjistruari elektronik fiskal nuk është i lidhur me një kompjuter ose në rastin kur përdoruesi nuk kryen shitje me regjistruarin elektronik fiskal duke përdorur kodet e artikujve dhe funksionin PLU por duke kryer shitjet përmes grupimit të artikujve në reparte dhe duke e përdorur repartin përkatës. Një procedurë lehtësuese për biznesin e vogël.

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij		Koka e kuponit
	LEK	Identifikon valutën kombëtare
1 x 60,00		
BAR	60,00 B	
1x60,00		
KAFETERI	60,00 C	Përshkrimi i REPARTIT, sasia, çmimi për njësi i shoqëruar nga germa që identifikon shkallën tatimore.
NENTOTALE	120,00	Totale parciale në pritje për mënyrat e pagesave ose valuta
TOTALE LEK	120,00	Totale në lekë
PARA NË DORË	200,00	Mënyrat e pagesës dhe llogaritja e mbetjes
MBETJE LEK	80,00	
VLERA PA TVSH B	50,00	Vlera pa TVSH sipas shkallëve tatimore
20%	10,00	Vlerat për shkallë tatimore
TVSH B 20%	54,00	
VLERA PA TVSH C	5,45	



10%	104,55	Vlera totale e shitur pa TVSH Vlera totale e TVSH së shitur
TVSH C 10%	15,45	
TOT. VL. PA TVSH TOTALE TVSH		
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXX DATA: 20/05/2008 13:11 KUPONI TATIMOR Nr. 20		Numri i identifikimit të regjistruarit elektronik fiskal Numri i regjistruarit elektronik (identifikimin e tij në rrjet p.sh supermarket) dhe operatori që ka shërbyer, data dhe ora, numri i kuponit tatimor
		Logo fiskale

### 2.5.3 Kopja e kuponit tatimor, prezantimi grafik dhe kuponi jotatimor

Çdo kupon tatimor që lëshohet shoqërohet me regjistrim të menjëhershëm në memorien fiskale dhe në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik, është e mundur gjithashtu të printohet dhe kopja e tij, e cila i ka të gjitha të dhënat e kuponit tatimor të sapo lëshuar, por kjo kopje është e formës KUPON JO TATIMOR për të mos krijuar dyfishimin e të dhënave të regjistruara në memorien fiskale.

#### Prezantimi grafik i kopjes së kuponit tatimor:

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij		Koka e kuponit																					
INFO JOTATIMORE  KOPJA E KUPONIT TATIMOR NR. 20		Tregon numrin e kuponit tatimor për të cilin lëshohet kopja																					
<table> <tr> <td></td> <td>LEK</td> <td></td> </tr> <tr> <td>1 x 60,00 BAR</td> <td>60,00 B</td> <td></td> </tr> <tr> <td>1x60,00 KAFETERI</td> <td>60,00 C</td> <td></td> </tr> <tr> <td>NENTOTALE</td> <td>120,00</td> <td></td> </tr> <tr> <td>TOTALE LEKË</td> <td>120,00</td> <td></td> </tr> <tr> <td>PARA NË DORË</td> <td>200,00</td> <td></td> </tr> <tr> <td>MBETJE LEKË</td> <td>80,00</td> <td></td> </tr> </table>		LEK		1 x 60,00 BAR	60,00 B		1x60,00 KAFETERI	60,00 C		NENTOTALE	120,00		TOTALE LEKË	120,00		PARA NË DORË	200,00		MBETJE LEKË	80,00			
	LEK																						
1 x 60,00 BAR	60,00 B																						
1x60,00 KAFETERI	60,00 C																						
NENTOTALE	120,00																						
TOTALE LEKË	120,00																						
PARA NË DORË	200,00																						
MBETJE LEKË	80,00																						
<table> <tr> <td>VLERA PA TVSH B 20%</td> <td>50,00</td> <td rowspan="2">10,00</td> </tr> <tr> <td>TVSH B 20%</td> <td></td> </tr> <tr> <td>VLERA PA TVSH C 10%</td> <td>54,00</td> <td></td> </tr> <tr> <td>TVSH C 10%</td> <td>5,45</td> <td></td> </tr> <tr> <td>TOT. VL. PA TVSH</td> <td>104,55</td> <td></td> </tr> <tr> <td>TOTALE TVSH</td> <td>15,45</td> <td></td> </tr> </table>	VLERA PA TVSH B 20%	50,00	10,00	TVSH B 20%		VLERA PA TVSH C 10%	54,00		TVSH C 10%	5,45		TOT. VL. PA TVSH	104,55		TOTALE TVSH	15,45							
VLERA PA TVSH B 20%	50,00	10,00																					
TVSH B 20%																							
VLERA PA TVSH C 10%	54,00																						
TVSH C 10%	5,45																						
TOT. VL. PA TVSH	104,55																						
TOTALE TVSH	15,45																						
DATA: 20/05/2008 13:11 KUPON JO TATIMOR Nr. 2 INFO JO TATIMORE		Kopja e kuponit tatimor regjistrohet në numratorin e kuponave jotatimor																					

Vlerat e prezantuara në kopjen e kuponit tatimor nuk regjistrohet në shumën totale të qarkulluar dhe të regjistruar në memorien fiskale, por regjistrohet në qarkun e shiritit të kontrollit për kontrole të mundshme mbi numërorin e kuponëve jotatimor.

Të gjitha veprimet që kryhen në regjimin e leximit dhe programimit pasi printohen, kuponët që lëshohen janë të natyrës “KUPON JO TATIMOR” dhe regjistrohen në numërorin e kuponëve jotatimor. Shenja dalluese e këtyre kuponëve është se në kokën dhe në këmbën e kuponit shënohet sigla “INFO JOTATIMORE” dhe në këto kuponë nuk shënohet logo fiskale dhe numri i identifikimit të pajisjes, të cilat janë shenja dalluese të KUPONIT TATIMOR.


#### 2.5.4 Përcaktimi i procedurës së kthimit të mallit, prezantimi grafik i kuponit


Klienti rikthen mallin e blerë duke paraqitur dhe dorëzuar kuponin tatimor origjinal të blerjes dhe në këmbim merr një mall tjetër me vlerë të barabartë ose më të madhe se malli i rikthyer.

Kuponi që del duhet të printohet në dy kopje ku një kopje i jepet klientit dhe kopja tjetër i formës JOTATIMORE lidhet së bashku me kuponin tatimor të mallit të kthyer dhe me kuponin e raportit tatimor-ditor në fund të ditës, dhe ruhet me raportet e tjera tatimore të periudhës përkatëse.


**KUPONI TATIMOR ORIGJINAL I MALLIT QË KTHEHET MBRAPSHI**

**KUPONI TATIMOR ME MALLIN E RI TË SHKËMBYER ME VLERË TË BARABARTË  
ME MALLIN E KTHYER MBRAPSHI**

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij	
	LEKË
1x600,00 BLUZË	600,00 B
NENTOTALE	600,00
TOTALE LEKË	600,00
PARA NË DORË	1000,00
MBETJE LEKË	400,00
VLERA PA TVSH 20%	480,00
TVSH B 20%	120,00
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXX DATA: 20/05/2008 13:11 KUPONI TATIMOR Nr. 20	
	

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij	
	LEKË
1x600,00 BLUZË	600,00 B
**RIKTHIM MALLI**	
1x600,00 BLUZË	-600,00 B
NENTOTALE	0,00
TOTALE LEKË	0,00
PARA NË DORË	
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXX DATA: 21/05/2008 13:11 KUPONI TATIMOR Nr. 21	
	

ose klienti që kërkon të rikthejë mallin me një tjetër artikull me vlerë më të madhe:

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij	
	LEKË
1x800,00 BLUZË	800,00 B
**RIKTHIM MALLI**	
1x600,00 BLUZË	-600,00 B
NENTOTALE	200,00
TOTALE LEKË	200,00
PARA NË DORË	
MBETJE LEKË	
VLERA PA TVSH 20%	166,67
TVSH B 20%	33,33
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXX DATA: 21/05/2008 13:11 KUPONI TATIMOR Nr. 22	
	


## 2.5.5 Funkzione ndihmëse

Regjistruesi elektronik fiskal lejon të kryejë funksione të tilla si:

- Fshirja e një rreshti (artikull të regjistruar)
- Anulimi i një artikulli;
- Anulimi i kuponit;
- Ulje ose rritje në % të artikullit të regjistruar;
- Ulje ose rritje në vlerë të artikullit të regjistruar;


Këto funksione janë të mundur vetëm në fazën e regjistrimit të shitjes dhe pa kryer mbylljen e kuponit tatimor. Në qoftë se tatimpaguesi e mbyll regjistrimin dhe lëshon kuponin tatimor pa kryer një nga këto funksione, çdo veprim i mëtejshëm lidhur me një nga këto funksione është i pamundur. Regjistruesi elektronik fiskal nuk lejon asnjë formë ndryshimi të informacionit të regjistruar në memorien fiskale. Kuponët tatimorë gabim duhet të kryhet ndryshimi në mënyrë manuale në kontabilitetin e tatimpaguesit dhe të pasqyrohet në librin e raporteve.

I. Procedura e fshirjes së një artikulli, prezantimi grafik i kuponit


EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij	
	LEKË
1 x 200,00 BLUZË	200,00 B
1 x 300,00 KËMISHA	300,00 B
**FSHI RRESHT**	
1 x 200,00 BLUZË	- 200,00 B
NENTOTALE	300,00
TOTALE LEKË	300,00
PARA NË DORË MBETJE LEKË	
VLERA PA TVSH 20%	250,00
TVSH B 20%	50,00
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXX DATA: 21/05/2008 13:11 KUPONI TATIMOR Nr. 23	
	

II. Procedura e anulimit të artikullit, prezantimi grafik i kuponit


EMRI I TATIMPAGUESIT  
ADRESA  
NUMRI I NIPT-it  
ose logo grafike e tij

	LEKË
1 x 200,00 BLUZË	200,00 B
<b>**ANULLIM**</b>	
BLUZË	-200,00 B
1 x 300,00 KËMISHA	300,00 B
NËNTOTALE	300,00
TOTALE LEKË PARA NË DORË MBETJE LEKË	300,00
VLERA PA TVSH	250,00
20% TVSH B 20%	50,00
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXXXX	
DATA: 21/05/2008 13:11	
KUPONI TATIMOR Nr. 24	
	


### III. Procedura e anulimit të kuponit, prezantimi grafik i kuponit

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij	
	LEKË
1 x 200,00 BLUZË	200,00 B
1 x 300,00 KËMISHA	300,00 B
<b>**FSHIRJE TOTALE KUPONIT**</b>	
	-500,00 B
NENTOTALE	0,00
TOTALE LEKË PARA NË DORË MBETJE LEKË	0,00
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXXXX	
DATA: 21/05/2008 13:11	
KUPONI TATIMOR Nr. 25	
	

### IV. Funkzioni i uljes ose rritjes së vlerës në %, prezantimi grafik i kuponit


EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij	
LEKË	
1 x 200,00 BLUZË	100,00 B
% ULJE PËR 10%	-10,00
1 x 300,00 KËMISHA	200,00 B
% RRITJE PËR 10%	20,00
NËNTOTALE	310,00
TOTALE LEKË PARA NË DORË	310,00
VLERA PA TVSH B 20%	258,33
TVSH B 20%	51,67
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXXXX DATA: 21/05/2008 13:41 KUPONI TATIMOR Nr. 26	
	

V. Funkzioni i uljes ose rritjes së vlerës në vlerë, prezantimi grafik i kuponit

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij	
LEKË	
1 x 200,00 BLUZË	100,00 B
ULJE PËR ART.	-10,00
1 x 300,00 KËMISHA	200,00 B
RRITJE PËR ART.	20,00
NËNTOTALE	310,00
TOTALE LEKË PARA NË DORË	310,00
VLERA PA TVSH B 20%	258,33
TVSH B 20%	51,67
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXXXX DATA: 21/05/2008 13:42 KUPONI TATIMOR Nr. 27	
	

2.5.6 Kuponi tatimor nga fatura tatimore, prezantimi grafik

Tatimpaguesi që ka lëshuar faturën tatimore është i detyruar të lëshojë dhe kuponin tatimor referuar kësaj fature, e cila duhet të shoqërohet me faturën tatimore. Kjo është e mundur përmes funksionit të “Kuponit Tatimor nga fatura tatimore” në regjistruerin elektronik fiskal. Vlera e faturës tatimore regjistrohet në kontabilitet, por regjistrohet dhe në memorien fiskale të regjistruarit elektronik fiskal në momentin që lëshohet kuponi tatimor. Për të mos pasur dyfishim të vlerave, regjistrimi i faturës tatimore është i specifikuar në detajet e xhiros-ditore në raportin tatimor ditore, në mënyrë që tatimpaguesi të ketë të evidentuar xhiron ditore përmes kuponëve tatimor (pa faturë tatimore) dhe xhiron ditore të kuponëve tatimor referuar faturave tatimore. Tatimpaguesi regjistron në kontabilitet vetëm pjesën e mbetur të xhiros, atë të kuponëve tatimor (pa faturë tatimore)

EMRI I TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI I NIPT-it ose logo grafike e tij	Koka e kuponit
FATURA TATIMORE NR. 150	Tregon numrin e faturës tatimor që i referohet kuponit tatimor
LEKË	
REPARTI 01 12.000,00	
NËNTOTALE 12.000,00	
TOTALE LEKË 12.000,00	Vlera totale me TVSH e faturës tatimore, grupohet përmes një reparti në regjistruerin elektronik fiskal
PARA NË DORË	
VLERA PA TVSH B 10.000,00	Vlera pa TVSH
20%	Vlera e TVSH
TVSH B 20% 2.000,00	
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXX	Numri i identifikimit të regjistruarit elektronik fiskal
DATA: 21/05/2008 13:45	Numri i regjistruarit elektronik (identifikimin e tij në rrjet p.sh supermarket) dhe operatori që ka shërbyer,
KUPONI TATIMOR Nr. 29	data dhe ora, numri i kuponit tatimor që i referohet faturës tatimore
	Logo fiskale

### 2.5.7 Prezantimi grafik i raporteve në regjimin e leximit (X)

Regjimi i leximit (X) shërben për të ndihmuar tatimpaguesin mbi mbarëvajtjen e aktivitetit, kontroll mbi xhiron ditore, statistika të ndryshme etj. Të gjitha këto raporte që lëshohen në këtë regjim janë të natyrës “JOTATIMORE”. Dallimi midis raporteve jo-tatimore dhe tatimore është:

- Koka e raportit në të cilën shënohet tipi i raportit dhe regjimit;
- Sigla “RAPORT JOTATIMOR” në fillim dhe në fund të kuponit;
- Mungesa në kupon i “LOGOS FISKALE” dhe “NUMRIT TË IDENTIFIKIMIT” të pajisjes fiskale;
- Nuk printohet përmbledhja totale e memories fiskale.

Raportet e leximit mbi xhiron janë të paraqitura me vlera për një xhiro të bërë me interval nga fillimi i ditës deri në momentin e printimit të raportit.

EMRI I TATIMPAGUESIT	
ADRESA	
NUMRI I NIPT-it	
ose logo grafike e tij	
RAPORT JO TATIMOR	
RAPORTI TATIMOR X	
DITOR	
SHITJET	
KLIENTË TË	12
SHËRBYER	
TOT. BRUTO	14.220,00
ULJE	
4	22,00
RRITJE	
3	44,00
TOT. NETO	14.242,00
RIKTHIM MALLI	
1	600,00
ANULLIME	
2	500,00
FSHIJ RRJESHTIN	
1	200,00
TOTALE E	
ANULLUAR	
1	500,00
KUPONA TATIMORE	
12	14.242,00
PARA NË DORË	
11	14.042,00
PEZULL	
1	200,00
TVSH	
TOTALET	
VLERA PA TVSH	11.872,88
TVSH	2.369,12
XHIRO DITORE	14.242,00
NGA TË CILAT	

KUPONA TATIMOR		
SHKALLA E TVSH B:		
20%		
VLERA PA TVSH		1.818,33
TVSH		363,67
TOTALE PËR		2.182,00
SHKALLË		
SHKALLA E TVSH		
C: 10%		
VLERA PA TVSH		54,55
TVSH		5,45
TOTALE PËR		60,00
SHKALLË		
TOTALE		
VLERA PA TVSH		1872,88
TVSH		369,12
TOTALE PËR		2242,00
KUPONA		
KUPONA NGA	FATURA	
TATIMORE		
SHKALLA E TVSH		
B: 20%		
VLERA PA TVSH		10.000,00
TVSH		2.000,00
TOTALE PËR		12.000,00
SHKALLË		
TOTALE		
VLERA PA TVSH		10.000,00
TVSH		2.000,00
TOTALE KUP. NGA	FAT.	12.000,00
FAT.		
GJENDJA E ARKËS		
PARA NË DORË		
11		14.042,00
DATA: 21/05/2008 13:45		
KUPON JO TATIMOR Nr. 5		
RAPORT JO TATIMOR		

Shpjegime:

1. Koka e raportit dhe emërtimi i tij;
2. Detajet mbi shitjet ditore;
3. Totale e xhiros ditore;
4. Detaje mbi totalen e xhiros ditore;



5. Gjendja e arkës;
6. Këmba e raportit.

1. Koka e raportit dhe emërtimi i tij

Në këtë pjesë specifikohet tipi i raportit që shërben dhe për identifikimin e tij që mund të jetë “JOTATIMOR” ose “TATIMOR”. Identifikimi bëhet përmes siglës së regjimit (X) dhe emërtimit “RAPORT JOTATIMOR”.

2. Detajet mbi shitjet ditore

Në këtë pjesë prezantohen si përmbledhje e gjithë puna e kryer gjatë ditës deri në çastin e printimit të këtij raporti. Informacioni mund të bëhet i përmbledhur në një rresht ose mund të jetë dhe në dy rreshta:

P.sh.:

Në 1 rresht

KLIENTË TË  
SHËRBYER  
TOT. BRUTO

12 - Tregon sa klientë janë shërbyer gjatë ditës deri në momentin e printimit të raportit  
14.220,0 - Tregon sa është vlera bruto e shitur  
0 pallogaritur uljet apo rritjet

Në 2 rreshta

ULJE

4

- Rreshti i parë tregon çfarë është kryer  
22,00 - Rreshti i dytë tregon sa herë është kryer dhe vlera totale

3. Totale e xhiros ditore

Në këtë pjesë prezantohet e gjithë xhiro e kryer deri në momentin e printimit të raportit, e cila është e ndarë në vlerën pa TVSh dhe sa është totale e TVSh. Kjo totale përmbledh sa është shitur me kuponë tatimore dhe me kuponë nga fatura tatimore.

4. Totale mbi detajet e xhiros ditore

Në këtë pjesë është e detajuar totale e xhiros ditore sipas formave të shitjes: sa është shitur me kuponë tatimore të detajuar sipas shkallëve tatimore dhe e përmbledhur në total dhe sa është shitur me kuponë tatimore referuar faturave tatimore të detajuar sipas shkallëve tatimore dhe e përmbledhur në total.

5. Gjendja e arkës

Identifikon sa është gjendja e arkës në monedhë dhe sa herë është paguar me para në dorë.

6. Këmba e raportit

Në këtë pjesë prezantohet se ky raport nga cili regjistruesi elektronik fiskal është printuar (për pajisjet fiskale në rrjet) dhe nga cili operator është kërkuar raporti, në çfarë date dhe ore. Të gjitha raportet jotatimore përmbledhen në numërorin e kuponëve jo-tatimorë. Në fund të kuponit printohet sigla “ RAPORT JOTATIMOR” për ta konfirmuar tipin e raportit.

### 2.5.8 Prezantimi grafik i raportit tatimor ditor – regjimi i mbylljes (Z)

Raporti tatimor ditor shërben për të kryer mbylljen ditore të aktivitetit. Vlerat totale të raportit përmbledhen në totalen e memories fiskale. Këto vlera tatimpaguesi i regjistron në librin e raporteve dhe në kontabilitetin e tij. Raporti tatimor ditor përmbledh të gjithë punën e kryer gjatë ditës nga tatimpaguesi dhe vlerat që përmbledhen në këtë raport janë pjesë e raportit periodik që regjistruesi elektronik fiskal dërgon në DPT. Raporti tatimor ditor përgatitet në regjimin (Z) të regjistruesit elektronik fiskal. Ky raport është i përbërë nga:

1. Koka e raportit dhe emërtimi i tij;
2. Detajet mbi shitjet ditore;
3. Totale e xhiros ditore;
4. Detaje mbi totalen e xhiros ditore;
5. Gjendja e arkës;
6. Përmbledhja e përgjithshme e totaleve në memorien fiskale;


## 7. Këmba e raportit.

Shenjat dalluese të raportit tatimor ditor janë:

- Koka e raportit në të cilën shënohet tipi i raportit dhe sigla e regjimit;
- Sigla “RAPORT TATIMOR” në fund të kuponit;
- Printimi i “LOGOS FISKALE” dhe “NUMRIT TË IDENTIFIKIMIT” të pajisjes fiskale në raport;
- Printimi i përmbledhjes totale të memories fiskale.

Pas printimit të raportit tatimor ditorë numërori i KUPONAVE TATIMORË dhe i KUPONAVE JOTATIMORË që janë lëshuar gjatë ditës zerohen.

EMRI I TATIMPAGUESIT	
ADRESA	
NUMRI I NIPT-it	
ose logo grafike e tij	
<b>RAPORT TATIMOR</b>	
RAPORTI TATIMOR DITOR	Z.
<b>SHITJET</b>	
KLIENTË TË SHËRBYER	12
TOT. BRUTO	14.220,00
ULJE	
4	22,00
RRITJE	
3	44,00
TOT. NETO	14.242,00
RIKTHIM MALLI	
1	600,00
ANULIME	
2	500,00
FSHIJ RRESHTIN	
1	200,00
TOTALE E ANULUAR	
1	500,00
KUPONA TATIMORE	
29	14.242,00
PARA NË DORË	
11	14.042,00
PEZULL	
1	200,00
TVSH	
TOTALET	
VLERA PA TVSH	11.872,88
TVSH	2.369,12
XHIRO DITORE	14.242,00
NGA TË CILAT	
KUPONA TATIMOR	
SHKALLA E TVSH B:	
20%	
VLERA PA TVSH	1.818,33
TVSH	363,67
TOTALE PËR SHKALLË	2.182,00
SHKALLA E TVSH C:	
10%	
VLERA PA TVSH	54,55
TVSH	5,45
TOTALE PËR SHKALLË	60,00
TOTALE	
VLERA PA TVSH	1872,88
TVSH	369,12
TOTALE PËR KUPONA	2242,00
KUPONA NGA FATURA TATIMORE	
SHKALLA E TVSH B:	
20%	
VLERA PA TVSH	10.000,00
TVSH	2.000,00
TOTALE PËR SHKALLË	12.000,00

TOTALE	
VLERA PA TVSH	10.000,00
TVSH	2.000,00
TOTALE KUP. NGA FAT.	12.000,00
GJENDJA E ARKËS	
PARA NË DORË	
11	14.042,00
RAPORTI TATIMOR DITOR NUM	33
NDËRHYRJE TEKNIKE	0
KUPONA TATIMORË	30
KUPONA JO TATIMORË	5
TOTALET E PËRGJITHSHME:	
XHIRO DITORE B	2.758.452,51
XHIRO DITORE C	60,00
XHIRO DITORE D	0,00
XHIRO DITORE E	0,00
XHIRO DITORE F	0,00
XHIRO DITORE G	0,00
XHIRO DITORE H	0,00
XHIRO DITORE I	0,00
PËRJASHTUAR A	0,00
SHUMA TOTALE	2.758.512,51
TVSH B	459.742,10
TVSH C	5,45
TVSH D	0,00
TVSH E	0,00
TVSH F	0,00
TVSH G	0,00
TVSH H	0,00
TVSH I	0,00
TOTALE TVSH	459.747,55
KUPONA TATIMORE	56
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXXXX	
DATA: 21/05/2008 21:45	
KUPONI TATIMOR Nr. 30	
	
<b>RAPORT TATIMOR</b>	

1

2

3

4

5

6

7

Shpjegime:

1. Koka e raportit dhe emërtimi i tij

Në këtë pjesë specifikohet tipi i raportit që shërben dhe për identifikimin e tij. Identifikimi bëhet përmes siglës së regjimit (Z) dhe emërtimit “RAPORT TATIMOR”.

2. Detajet mbi shitjet ditore

Në këtë pjesë prezantohen si përmbledhje e gjithë puna e kryer gjatë ditës. Informacioni mund të bëhet i përmbledhur në një rresht ose mund të jetë dhe në dy rreshta:

P.sh.:

Në 1 rresht

KLIENTË TË SHËRBYER  
e printimit të raportit

12 - Tregon sa klientë janë shërbyer gjatë ditës deri në momentin

TOT. BRUTO  
apo rritjet

14.220,00 - Tregon sa është vlera bruto e shitur pallogaritur uljet

Në 2 rreshta

ULJE

- Rreshti i parë tregon çfarë është kryer

4

22,00 - Rreshti i dytë tregon sa herë është kryer dhe vlera totale

3. Totale e xhiros ditore

Në këtë pjesë prezantohet e gjithë xhiro jadorë e kryer e cila është e ndarë në vlerën pa TVSH dhe sa është totale e TVSH. Kjo totale përmbledh sa është shitur me kuponë tatimorë dhe me kuponë nga fatura tatimore. Këto vlera shkruhen në librin e raporteve.

4. Totale mbi detajet e xhiros ditore

Në këtë pjesë është e detajuar totale e xhiros ditore sipas formave të shitjes: sa është shitur me kuponë tatimorë të detajuar sipas shkallëve tatimore dhe e përmbledhur në total dhe sa është shitur me kuponë tatimorë referuar faturave tatimore të detajuar sipas shkallëve tatimore dhe e përmbledhur në total.

5. Gjendja e arkës

Identifikon sa është gjendja e arkës në monedhë dhe sa herë është paguar me para në dorë.

6. Përmbledhja e përgjithshme e totaleve në memorien fiskale

Në këtë pjesë paraqitet vlerat totale të regjistruar në memorien fiskale që nga dita e fiskalizimit të pajisjes fiskale deri në ditën që po shqyrtohet.

7. Këmba e raportit

Në këtë pjesë printohet NUMRI I IDENTIFIKIMIT të pajisjes fiskale, numri i regjistruarit nga cili regjistruar elektronik fiskal është printuar raporti (për pajisjet fiskale në rrjet) dhe nga cili operator, në çfarë date dhe ore. Të gjithë raportet tatimore regjistrohen në numërorin e kuponëve tatimorë të memories fiskale. Në fund të kuponit printohet LOGO FISKLAE dhe sigla “RAPORT TATIMOR” për ta konfirmuar tipin e raportit.

2.5.9 Prezantimi i kuponit dhe raporteve që kryhen në funksionin e trajnimit Në këtë fazë të gjitha hapësirat në kuponët e lëshuar duhet të mbushen nga simboli “?” dhe në kokën, qendrën dhe këmbën e kuponit vendoset sigla “INFO JOTATIMORE”. Shembull i kuponit:

<p>??EMRI?I?TATIMPAGUESIT??          ??????????ADRESA????????????          ??????NUMRI? I?NIPT-it????          ???ose logo?grafike?e?tij???</p> <p>????????????????????????????????????</p> <p>????LEK</p> <p><b>INFO?JO?TATIMORE</b>          I?x?60,00????????          ?????????????????????  <b>BAR????????????????</b> ?????          ?????????????????60,          00?B</p> <p><b>TOTALE?LEK???</b> ?????60,00          ????</p> <p><b>PARA?NË?DORË????????????</b>          ?????????</p> <p><b>VLERA?PA?TVSH?B?</b> ?????          20%???? 50,00  <b>TVSH?B?20%????????</b>          ?????????????????1          0,00</p> <p><b>INFO?JO?TATIMORE</b>  <b>REGJIST.?001??</b>  <b>OPERATORI?1????????????</b>  <b>DATA:??20-05-</b>  <b>2008?13:11????????????</b>  <b>KUPON?TATIMOR?Nr.??2????</b>          ?????????</p> <p><b>INFO?JO?TATIMORE</b></p>
---

E njëjta procedurë është e vlefshme dhe për raportet që lëshohen në këtë regjim. Të gjitha fushat boshe mbushen me shenjën “?” dhe në mënyrë të përsëritur mbi raport shënohet sigla “INFO JOTATIMORE”.

## 2.6 Certifikimi i pajisjeve fiskale

Shoqëritë e autorizuar për furnizimin e regjistruessve elektronikë, janë të detyruara të certifikojnë llojet e regjistruessve që do të hedhin në treg, në Drejtorinë e Metrologjisë dhe Kalibrimit, e cila verifikon nëse tipi i regjistruessit elektronik plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në këtë kontratë. Drejtoria e Metrologjisë dhe Kalibrimit për çdo model të regjistruessve elektronikë fiskal të certifikuar i dërgon një raport teknik Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku përveç të dhënave teknike të modelit duhet të përmbajë edhe të dhëna identifikuese të modelit (Kodin e shoqërisë dhe Kodin e modelit).

## 2.7 Procedura e pajisjes me regjistruess elektronik fiskal e tatimpaguesit

### 1. Tatimpaguesi:

- Tatimpaguesi zgjedh modelin e regjistruessit elektronik sipas nevojave të tij;
- Plotëson formularin e kërkesës për pajisjen me regjistruess fiskal elektronik pranë shoqërisë së autorizuar e cila tregton regjistruessin fiskal elektronik që ai dëshiron, në 3 tri kopje, nga të cilat një e mban vetë;
- Lidh kontratën me shoqërinë e autorizuar dhe bën pagesën e pajisjes fiskale;
- Dorëzon pranë shoqërisë së autorizuar listën e të dhënave që duhet të programohen në kasë

(lista e mallrave/shërbimeve, çmimet etj...);

e) Asiston në fiskalizimin e regjistruarit elektronik;

f) Trajtohet nga shoqëria e autorizuar për përdorimin e regjistruarit elektronik;

g) Pajiset me manualin e përdorimit të pajisjes fiskale në gjuhën shqipe, ku përveç te tjerave, në manual paraqiten pikat e shërbimit, si edhe numrat e kontaktit.

2. Shoqëria e autorizuar:

a) Shoqëria e autorizuar një kopje të formularit të kërkesës së bashku me fotokopjen e faturës);

b) Bën përgatitjen (lidhjen me pajisje të tjera ndihmëse: lexues të kartave bankare, pajisjet e transmetimit *on-line* etj...) dhe programimin e regjistruarit elektronik sipas nevojave të tatimpaguesit

c) Bën kontrollin teknik dhe vulosjen e regjistruarit elektronik;

d) Bën fiskalizimin e regjistruarit elektronik;

e) Dërgon teknikun përkatës për instalimin e regjistruarit elektronik në mjediset e tatimpaguesit;

f) Bën trajnim e tatimpaguesit për përdorimin e regjistruarit elektronik;

3. Organet tatimore:

a) Asiston në kontrollin teknik dhe vulosjen e regjistruarve elektronikë;

b) Asiston në fiskalizimin e regjistruarit elektronik. 2.8 Forma e skedarit të transmetimit

Për të transmetuar raportet tatimore periodike programi logjik duhet të parashikojë krijimin e një skedari me format ASCII ku fushat janë të. Ky raport periodik që pajisjet fiskale dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përbëhet nga:

- Koka e raportit;

- Të dhënat e raportit periodik;

- Rreshti i kontrollit (Numri i kontrollit [Checksum]); Koka e raportit ka këto të dhëna:

- Numrin e identifikimit të pajisjes fiskale;

- Ditën, muajin, vitin, orën dhe minutën e përgatitjes së raportit;

- Ditën e fillimit nga nis ky raport;

- Ditën e mbarimit të raportit;

- Numrin e raporteve tatimore ditore;

- Vlerën e qarkullimit total të mallrave dhe të shërbimeve për periudhën e raportit;

- Shumën totale të TVSH për periudhën;

- Numrin e kuponëve tatimore, të lëshuar nga pajisja fiskale ndërmjet dy datave. Të dhënat e raportit periodik

Të dhënat e raportit periodik janë aq rreshta sa janë raportet tatimore ditore të periudhës dhe secili rresht paraqet të njëjta të dhëna të raportit tatimor ditor. Rreshtat e të dhënave të raportit renditen sipas ditëve të muajit për të cilën përgatitet raporti periodik:

- Ditën, muajin, vitin, orën dhe minutën e përgatitjes së raportit tatimor ditor;

- Numrin e kuponëve tatimor të lëshuar nga pajisja fiskale për atë ditë;

- Vlerën e qarkullimit sipas shkallëve tatimore, dhe/ose të përjashtimeve tatimore;

- Shumën totale të TVSH sipas shkallëve tatimore. Rreshti i kontrollit (Numri i kontrollit [Checksum])

Checksumi përgatitet me një algoritëm MD5 (standard RFC 1321). Ky kodifikim në "input" parashikon një "string" me gjatësi të diktuar mbi të gjithë vlerat e raporteve tatimore ditore të periudhës dhe në "output" një string (MD5 Checksum) me 128 bit (me vlera 32 hexadecimale) në mënyrë të pavarur nga "string" e "input" që përdoret. MD5 Checksum dërgohet bashkë me të dhënat me skedarin e transmetuar dhe rillogaritet në fazën e regjistrimit në serverin qendror.

Shembull i skedarit të transmetuar:

XZ12423432 020720080845 01062008 30062008 32 32000 8000 40

060620082055 2 0 0 0 0 0 0 100 0 0 0 0 0 0 20


070620082135 1 0 0 0 0 0 0 50 0 0 0 0 0 0 10

080620081925 3 45 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0 0

090620081605 2 0 0 0 0 0 100 0 0 0 0 0 0 10 0  
FADABCE7D0C989A8DF0A021847919F55

Regjistruesi elektronik fiskal pasi të kryejë transmetimin duhet të printojë një kupon në të cilin ka përmbledhur të gjitha vlerat që ka transmetuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Ky kupon shërben për tatimpaguesin, i cili e ruan atë në librin e raporteve për të vërtetuar dërgimin e të dhënave dhe vlerat e dërguara duhet të jenë të njëjta me ato të regjistruara në serverin qendror.

#### SHEMBULL I KUPONIT TË TRANSMETIMIT TË RAPORTIT PERIODIK

EMRI TATIMPAGUESIT ADRESA NUMRI NIPT – it ose logo grafike e tij	
RAPORTI TATIMOR PERIODIK	
Data e fillimit	01-06-2008
Data e mbarimit	30-06-2008
Raporte tatimore	31
Qarkullimi Total	32.000,00
Totali i TVSH	5.000,17
Kupona tatimore	40
XHIRO PËRJASHTUAR A:	0,00
XHIRO DITORE B	32.000,00
XHIRO DITORE C	0,00
XHIRO DITORE D	0,00
XHIRO DITORE E	0,00
XHIRO DITORE F	0,00
XHIRO DITORE G	0,00
XHIRO DITORE H	0,00
XHIRO DITORE I	0,00
TVSH B	2.064,00
TVSH C	0,00
TVSH D	0,00
TVSH E	0,00
TVSH F	0,00
TVSH G	0,00
TVSH H	0,00
TVSH I	0,00
TRANSMETIMI OK	
NR. REGJ. ELEKTRONIK: XXXXXXXXXXXX	
DATA: 02/07/2008 08:45	
	

#### 2.8.1 Emërtimi i skedarit të transmetimit

Emërtim i skedarit është i formës:

Numri i identifikimit të regjistruarit elektronik fiskal, periudha për të cilën po transmeton\_viti dhe më pas tipi i skedarit \*.txt

pra:

XX00111111\_08\_2008.txt

#### 2.9 Numri i identifikimit të regjistruarit elektronik fiskal

Për të mos pasur konflikte të numrave të identifikimit të regjistruarve elektronik fiskal, numri i identifikimit të regjistruarit është i përbërë nga dy pjesë të cilat së bashku garantojnë siguri për regjistruarve elektronik.

Pjesa e parë.

Identifikimi i shoqërive të autorizuara përmes dy germave që i ka vendosur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

EMRI I SHOQËRISË SË AUTORIZUAR	KODI IDENTIFIKUES
A.E. Distribution sh.p.k.	AE
I.V.A. Elektronik sh.p.k.	IV
BNT Electronics sh.p.k.	BN
CKV NUSHI-CFV NOKI	CK
Rilindja sh.p.k. dhe P.K.P sh.p.k	RL

Modelet e pajisjeve fiskale. Secila nga shoqëritë e autorizuara është e detyruar të certifikojë regjistruarve elektronikë fiskalë që do të hedhin në treg pranë DPM. Secila nga këto pajisje që është certifikuar do të identifikohet nga 2 shifra që fillojnë nga 00-99 për secilën shoqëri.

SHOQËRIA	KODI SHOQËRISË	KODI MODELIT
A.E. Distribution sh.p.k.	AE	Nga 00 - Në 99
I.V.A. Elektronik sh.p.k.	IV	Nga 00 - Në 99
BNT Electronics sh.p.k.	BN	Nga 00 - Në 99
CKV NUSHI-CFV NOKI	CK	Nga 00 - Në 99
Rilindja Sh.p.k. dhe P.K.P sh.p.k	RL	Nga 00 - Në 99

Pjesa e dytë.

Numri serial i regjistruarit është një numër që e lëshon fabrika prodhuese. Secila nga shoqëritë për çdo model që certifikon ka mundësi të prodhojë nga seriali 000000 deri në 999999 pajisje. Të dyja këto pjesë përbëjnë numrin e identifikimit i cili i regjistrohet pajisjes fiskale vetëm një herë në momentin fillestar dhe është i pandryshueshëm.

Shembull:

SHOQËRIA	KODI	KODI MOD.	SERIALI
A.E. Distribution sh.p.k.	AE	00-99	Nga 000000 – Në 999999
I.V.A. Elektronik sh.p.k.	IV	00-99	Nga 000000 – Në 999999
Toshiba BNT Elektronik sh.p.k.	BN	00-99	Nga 000000 – Në 999999
CKV NUSHI-CFV NOKI	CK	00-99	Nga 000000 – Në 999999
Rilindja Sh.p.k.	RL	00-99	Nga 000000 – Në 999999

Shoqëria “Drejtoria e Përgjithshme” me kod identifikimi “DP” ka certifikuar pajisjen fiskale model “FUTURA” në DPM, e cila identifikohet me kodin e modelit “12”

Numrat e identifikimit të këtij modeli janë:

Fillojnë nga: DP12000000

Mbarojnë në: DP12999999

2.9.1 Vula identifikuese e teknikëve të autorizuar

Shoqëritë e autorizuara janë të detyruara të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve listën e teknikëve të autorizuar. Çdo teknik i autorizuar identifikohet përmes kodit të identifikimit të shoqërisë së autorizuar dhe kodit me shifra sipas renditjes në listën e shoqërive të autorizuara.



SHOQËRIA	KODI SHOQËRISË	KODI TEKNIKUT
A.E. Distribution sh.p.k.	AE	Nga 01 - Në 999
I.V.A. Elektronik sh.p.k	IV	Nga 01 - Në 999
Toshiba BNT Elektronik sh.p.k.	BN	Nga 01 - Në 999

CKV NUSHI-CFV NOKI CK Nga 01 - Në 999

Rilindja Sh.p.k. RL Nga 01 - Në 999

Shoqëritë e autorizuar duhet të pajisin teknikët e tyre me goditësin (punconin) me kodet identifikuese të secilit prej tyre në mënyrë që mbi vulën fiskale të pajisjes fiskale të shënohet kodi identifikues i teknikut që ka kryer fiskalizimin apo kontrollin periodik. I njëjti kod vendoset dhe në etiketat e kontrollit periodik dhe në dokumentacionin përkatës të pajisjes fiskale.

Shembull:

Tekniku i autorizuar me initiale Z.Z. i shoqërisë së autorizuar “Drejtoria e Përgjithshme” me kod identifikimi “DP”, është i renditur në listën e teknikëve me numrin 01.

Kodi identifikues ose vula identifikuese e këtij tekniku është: DP01

Pajisja fiskale model “FUTURA” me numër identifikimi DP12000123 është fiskalizuar dhe kryer kontrolli teknik periodik nga tekniku i autorizuar DP01, i cili është i detyruar të ketë lënë shenjën DP01 në vulën fiskale dhe të ketë vendosur në pamjen ballore dhe të dukshme për publikun etiketën pozitive të kontrollit periodik duke specifikuar skadencat e tij në shkurt të vitit 2009.



### 3. SISTEMI ELEKTRONIK ME MEMORIE FISKALE PËR REGJISTRIMIN E QARKULLIMIT TË SHITJES ME PAKICË TË DERIVATEVE TË NAFTËS (STACIONET E NAFTËS, GAZIT)

Pompat e karburantit dhe të GPL janë të detyruara të instalojnë regjistruenin elektronik fiskal.

Sistemi elektronik me memorie fiskale për regjistrimin e qarkullimit të karburantit bazohet në ndërfaqen e logjikës së regjistruenit elektronik fiskal me një njësi elektronike kontrolli mbi pompën e karburantit. Shkëmbimi i të dhënave bëhet në bazë të një protokollit të programuar sipas specifikash të pompës së karburantit.

Furnizimi me karburant duhet të jetë e lidhur saktësisht me regjistrimin e shitjeve dhe duhet të punojë nën rregullin e detyrueshëm “PA KUPON TATIMOR – S’KA KARBURANT.”

Të gjitha shitjet duhet të regjistrohen në memorien fiskale dhe çdo pikë karburanti për secilën pompë duhet të pajiset me regjistruenin elektronik fiskal të pompës.

Pompa është e pajisur me një “njësi ndërfaqe pompe (PIR)” për transferimin e të dhënave të shitjes. Kjo njësi (PIR) përpunon të dhënat e shitjes së pompës së karburantit dhe i dërgon këto të dhëna në regjistruenin elektronik fiskal të pompës.

Kjo njësi (PIR) duhet të memorizojë të dhënat e shitjes për 48 orë në rast të ndonjë defekti.

Regjistrueni elektronikë fiskalë të pompës duhet të sigurojnë funksionin për:

Temperaturë të ambientit - 30°C / +55 °C

Lagështia

5 % - 95 %

duhet të jenë të pajisur me certifikatë CE dhe programi logjik i regjistruarit elektronik fiskal të pompës duhet të plotësojë të gjitha kriteret sipas këtij udhëzimi mbi regjistruarit elektronik fiskalë. Ai duhet të transmetojë raportet tatimore periodike në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

3.1 Lidhja e pompave të karburantit me regjistruarit elektronik fiskalë.

a) Pompat e karburantit dhe të gazit duhen të jenë të lidhur me një regjistruar elektronik fiskal. Regjistruari elektronik fiskal duhet të vendoset pas pompës

b) Furnizimi me karburant mund të kryhet vetëm pasi është regjistruar targa e automjetit, në rast të kundërt nuk është e mundur shitja e karburantit për automjetin. Në rast furnizimi me karburant apo GPL për fuçi, bombola etj., duhen futur fillimisht të dhënat e blerësit (emri, mbiemri ose titulli) në mungesë të targës së automjetit;

c) Të dhënat mbi shitjen e karburantit duhen të ruhen automatikisht në memorien e fiskale të regjistruarit elektronik fiskal, si dhe në qarkun e shiritit të kontrollit. Vlerat e qarkulluara certifikohen në mënyrë automatike me lëshimin e kuponit tatimor nga regjistruari elektronik fiskal. Kuponi tatimor duhet të përmbajë:

- të dhënat identifikuese të blerësit (Targa e automjetit ose emër, mbiemër);
- llojin e karburantit;
- sasinë e shitur;
- vlerën e karburantit të shitur;
- vlerën e shitur sipas shkallës tatimore;
- vlera e shkallës tatimore;
- numrin e pompës;
- numrin e identifikimit të regjistruarit fiskal;
- data, ora e shitjes;
- numëratori i kuponëve tatimorë;
- logo fiskale.

Struktura e numrit të identifikimit të regjistruarit elektronik fiskal të pompave dhe logo fiskale janë të njëjtë me atë të përshkruar më lart në këtë udhëzim.

Targa e automjetit duhet të shënohet në një rresht të vetëm të kuponit poshtë detajeve të tatimpaguesit, me shkronja kapitale (bold). Struktura e targës duhet të paraqitet në këtë mënyrë: sigla e rrethit, seriali i numrave dhe germa identifikuese e serialit duhet të shkruhen me hapësirë nga njëra-tjetra,  
p.sh. TR XXXX A.

d) Kuponi tatimor i lëshuar nga regjistruari elektronik fiskal i pompës për t'u pranuar si shpenzim duhet të shoqërohet me një faturë tatimore në të cilën duhet të shënohet numri i kuponit tatimor të lëshuar për të cilën i referohet.

e) Në rast defekti të regjistruarit elektronik fiskal, pompa do të vazhdojë të veprë manualisht derisa dëmtimi të rregullohet. Të dhënat e shitjes gjatë veprimit manual të pompës duhet të ruhen në njësinë e ndërfaqes së pompës "PIR" e vendosur në pjesën elektronike të pompës. Këto të dhëna regjistrohen automatikisht në memorien fiskale dhe në qarkun e shiritit të kontrollit të regjistruarit elektronik fiskal menjëherë pas riparimit të defektit, të cilat do të paraqiten në raportin tatimor-ditor "Z" të ditës kur është riparuar regjistruari elektronik fiskal. Riparimi i regjistruarit elektronik fiskal duhet të kryhet brenda 36 orëve. Në rast defekti të regjistruarit elektronik fiskal, tatimpaguesi është i detyruar të lëshojë dëftesa tatimore për shitjet e kryera në regjimin manual të pompës.

3.2 Specifikime teknike dhe funksionale të regjistruarit elektronik fiskal të pompës

a) Sistemi është i përbërë nga dy pajisje , një nga të cilat është regjistruari elektronik fiskal me memorien fiskale dhe qarkun e shiritit të kontrollit dhe njësia e ndërfaqes së pompës "PIR", e cila lidhet me pjesën elektronike të pompës dhe regjistruarin elektronik fiskal. Njësia e

ndërfaqes së pompës “PIR” regjistron shitjet në rast defekti të regjistruesit elektronik fiskal.

b) Regjistruesi elektronik fiskal duhet të komandojë pompën në të cilën është lidhur. Pompa duhet të punojë vetëm në regjimin automatik.

c) Në rast ndërprerje të lidhjes midis pompës së karburantit dhe regjistruesit elektronik fiskal, pompa nuk duhet të jetë e aftë të veprojë në regjimin manual. Ky regjim aktivizohet nga tekniku i autorizuar vetëm në rast defekti të pajisjes fiskale. Tekniku i autorizuar duhet të regjistrojë veprimin në librin e mirëmbajtjes.

d) Në rast mbarimi të letrës ose koka e printerit është e hapur; pompa nuk duhet të jetë e aftë të veprojë.

e) Në rast defekti, njësia e ndërfaqes së pompës ruan totalin e shitjeve për 48 orë. Mbas 48 orëve, në qoftë se defekti vazhdon, pompa bllokohet dhe nuk lejohet të funksionojë. Pasi regjistruesi elektronik fiskal riparohet dhe lidhet me sistemin, njësia e ndërfaqes së pompës i dërgon të dhënat e shitjes regjistruesit elektronik fiskal në mënyrë automatike. Regjistruesi elektronik fiskal nxjerr një raport ku përfshin të dhënat e shitjes për periudhën e defektit.

f) Memories fiskale duhet të ketë të njëjtat parametra teknike të përshkruar në VKM nr.781 të datës 14.11.2007.

g) Në memorien fiskale regjistrohen të dhënat e detajeve të raporteve tatimore ditore “Z”.

Informacioni që duhet të regjistrohet në memorien fiskale është:

- Data (sipas formës data, muaji dhe viti);
- Totale e vlerës së qarkulluar sipas shkallës tatimore;
- Totale e vlerës së TVSH;
- Tipi i karburantit dhe sasia e shitur.

Raporti tatimor ditor “Z” përmban këto vlera për ditën që po lëshohet ky raport dhe në fund të tij është përmbledhja e të gjitha këtyre vlerave që nga dita e parë e fiskalizimit deri në atë ditë.

h) Pompat dhe regjistruesit elektronikë fiskalë të pompave duhet të certifikohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit.

i) Të gjitha stacionet duhet të pajisen me pompa që të punojnë në mënyrë automatike, të cilat lejojnë lidhjen me regjistruesin elektronik fiskal. Në qoftë se është i pajisur me pompa mekanike, këto pompa duhet të zëvendësohen me pompa që kanë mundësi lidhjeje.

j) Pompat duhet të kenë të aktivizuar vetëm funksionin në regjim automatik. Regjimi manual i veprimit duhet çaktivizuar dhe mund të aktivizohet vetëm nga tekniku i autorizuar. Përdoruesi nuk duhet të lejohet për vendosjen e pompës në mënyrë manuale.

k) Të gjitha pompat duhet të përdorin protokolle komunikimi të standardeve globale për lidhjen siç janë Wayne Dart, Gilbarco ose Tokheim.

### 3.3 Procedura e pajisjes me regjistrues elektronik fiskal e tatimpaguesit

#### 1. Tatimpaguesi:

a) Tatimpaguesi zgjedh modelin e regjistruesit elektronik sipas nevojave të tij.

b) Plotëson formularin e kërkesës për pajisjen me regjistrues fiskal elektronik pranë shoqërisë së autorizuar, e cila tregton regjistruesin fiskal elektronik që ai dëshiron, në 3 tri kopje, nga të cilat një e mban vetë.

c) Lidh kontratën me shoqërinë e autorizuar dhe bën pagesën e pajisjes fiskale.

d) Dorëzon pranë shoqërisë së autorizuar listën e të dhënave që duhet të programohen në kasë (lista e mallrave/shërbimeve, çmimet etj...)

e) Asiston në fiskalizimin e regjistruesit elektronik.

f) Trajtohet nga shoqëria e autorizuar për përdorimin e regjistruesit elektronik.

g) Pajiset me manualin e përdorimit të pajisjes fiskale në gjuhën shqipe, ku përveç të tjerave, në manual paraqiten pikat e shërbimit, si edhe numrat e kontaktit.

#### 2. Shoqëria e autorizuar:

a) Shoqëria e autorizuar një kopje të formularit të kërkesës së bashku me fotokopjen e

faturës e dërgon në organet tatimore përkatëse.

b) Bën instalimin (lidhjen me pompën dhe pajisje të tjera ndihmëse: lexues të kartave bankare, pajisjet e transmetimit *on-line* etj...) dhe programimin e regjistruarit elektronik sipas nevojave të tatimpaguesit.

c) Bën kontrollin teknik dhe vulosjen e regjistruarit elektronik.

d) Bën fiskalizimin e regjistruarit elektronik.

e) Dërgon teknikun përkatës për instalimin e regjistruarit elektronik në mjediset e tatimpaguesit.

f) Bën trajnim e tatimpaguesit për përdorimin e regjistruarit elektronik.

3. Organet tatimore:

a) Asiston në kontrollin teknik dhe vulosjen e regjistruarve elektronikë.

b) Asiston në fiskalizimin e regjistruarit elektronik.

3.4 Procedura e shitjes

Hapi 1 Pozicioni në pritje, zgjidhet ana e pompës ku kërkohet furnizimi

Hapi 2 Përzgjedhja e veprimit:

- Shitje duke vendosur të dhënat e blerësit (Targa e automjetit ose emri mbiemri)

- Veprime të brendshme (test ose transferim)

Identifikimi i automjetit = Regjistruari elektronik fiskal kërkon nga njësia e ndërfaqes nëse automjeti është në LISTËN E ZEZË ose jo

Lista e zezë = Nëse automjeti është në listën e zezë; Njësia e ndërfaqes i dërgon komandën regjistruarit elektronik fiskal "NDALOHET FURNIZIMI ME KARBURANT". Në këtë rast, shkruhet mesazhi në ekranin e regjistruarit elektronik fiskal "AUTOMJETI është në LISTËN E ZEZË"

Kalohet te hapi 7

Lista e bardhë = Nëse automjeti është në listën e bardhë; Njësia e ndërfaqes i dërgon komandën regjistruarit elektronik fiskal "FURNIZOJË ME KARBURANT". Në këtë rast, shkruhet mesazhi në ekranin e regjistruarit elektronik fiskal "AUTOMJETI është në LISTËN E BARDHË"

Hapi 3 Regjistruari elektronik fiskal dërgon komandën njësisë së ndërfaqes "FURNIZOJË ME KARBURANT"

Njësia e ndërfaqes dërgon komandën "Hape valvolën për pistoletën"

Hapi 4 Procedohet me furnizimin e automjetit

Hapi 5 Zgjidhet mënyra e pagesës; Para në dorë, kartë krediti, pezull, çek bankar, tollon etj.

Hapi 6 Regjistruari elektronik printon kuponin tatimor

Hapi 7 Pozicioni në pritje

3.5 Shembuj të kuponit tatimor

Certifikimi i vlerës së qarkulluar mund të jetë sipas 5 mënyrave si më poshtë:

a) Shitje përmes targës = Mënyra e paracaktuar = Shitje për automjetin përmes numrit të targës.

b) Identifikim i automjetit = të dhëna mbi targën vijnë nga sistemi = shitje për automjetin


përmes identifikimit të numrit të targës.

c) Shitje me fuçi, bidon = Shitje me fuçi, bidon etj... është e mundur duke vendosur “Emrin dhe adresën e blerësit”.


d) Teste në stacion = Nëse karburanti merret nga pompa me “qëllim testi” në stacion.

e) Transferim në stacion = Nëse karburanti merret nga pompa për “qëllim transferimi” në stacion.


### 3.5.1 Shitje përmes targës - Targa vendoset përmes tastierës.

Emri i Tatimpaguesit Adresa Numri Niptit (ose logo grafike e tij)	Të dhënat e tatimpaguesit
TR XXXX A (TARGA)	Targa e automjetit
10 LT X 125,00 BENZIN 1.250,00	Tipi dhe vlera e qarkulluar
TOTAL 1.250,00 PARA NË DORË 1.250,00	Vlera për shkallë tatimore
VLERA ME TVSH 20% 1.041,67 TVSH 20% 208,33	Numri i pompës Numri i identifikimit të regjistrusit elektronik fiskal Data, ora Numratori i kuponave tatimor
POMPA NR: 2 REGJ. ELEKTRONIK NR. XXXXXXXXXXXX 19-05-2008 Ora : 15:45 KUPONI TATIMOR : 20	Logo fiskale
	

### 3.5.2 Identifikim i automjetit - kuponi kthehet në faturë

Emri i Tatimpaguesit Adresa Numri Niptit (ose logo grafike e tij)	Të dhënat e tatimpaguesit
TR XXXX A (TARGA)	Targa e automjetit
10 LT X 125,00 BENZIN 1.250,00	Tipi dhe vlera e qarkulluar
TOTAL 1.250,00 PARA NË DORË 1.250,00	Vlera për shkallë tatimore
VLERA ME TVSH 20% 1.041,67 TVSH 20% 208,33	Për automjetin ose blerësin është identifikuar shitja. Kuponi do të kthehet në faturë
POMPA NR: 2 REGJ. ELEKTRONIK NR. XXXXXXXXXXXX 19-05-2008 Ora : 15:45 KUPONI TATIMOR : 20	Numri i identifikimit të regjistruarit elektronik fiskal Data, ora Numratori i kuponave tatimor
	Logo fiskale

### 3.5.3 Shitje me fuçi, bidona etj.

Emri i Tatimpaguesit Adresa Numri Niptit (ose logo grafike e tij)	
EMRI DHE MBIEMRI ADRESA	
10 LT X 125,00 BENZIN	1.250,00
TOTAL	1.250,00
PARA NË DORË	1.250,00
VLERA ME TVSH 20%	1.041,67
TVSH 20%	208,33
POMPA NR: 2 REGJ. ELEKTRONIK NR. XXXXXXXXXXXX 19-05-2008 Ora : 15:45 KUPONI TATIMOR : 20	
	

Të dhënat e tatimpaguesit

Emri dhe mbiemri i blerësit me adresën

Tipi dhe vlera e qarkulluar

Vlera për shkallë tatimore

Numri i pompës

Numri i identifikimit të regjistrusit elektronik fiskal


Data, ora

Numratori i kuponave tatimor

Logo fiskale

Është e mundur të regjistrohen të dhëna deri në 4 rreshta për emrin, mbiemrin dhe adresën e blerësit.

### 3.5.4 Kupon tatimor për "TEST"

Emri i Tatimpaguesit Adresa Numri Niptit (ose logo grafike e tij)	
TEST	
10 LT X 125,00 BENZIN	1.250,00
TOTAL	1.250,00
PARA NË DORË	1.250,00
VLERA ME TVSH 20%	1.041,67
TVSH 20%	208,33
POMPA NR: 2 REGJ. ELEKTRONIK NR. XXXXXXXXXXXX 19-05-2008 Ora : 15:45 KUPONI TATIMOR : 20	
	

Të dhënat e tatimpaguesit

TEST

Tipi dhe vlera e qarkulluar

Vlera për shkallë tatimore

Numri i pompës


Numri i identifikimit të regjistrusit elektronik fiskal

Data, ora

Numratori i kuponave tatimor

Logo fiskale

### 3.5.5 Kupon tatimor për "TRANSFERIM"

Emri i Tatimpaguesit	
Adresa	
Numri Niptit (ose logo grafike e tij)	
TRANSFERIM	
10 LT X 125,00 BENZIN	1.250,00
TOTAL	1.250,00
PARA NË DORË	1.250,00
VLERA ME TVSH 20%	1.041,67
TVSH 20%	208,33
POMPA NR: 2	
REGJ. ELEKTRONIK NR. XXXXXXXXXXX	
19-05-2008	Ora : 15:45
KUPONI TATIMOR : 20	
	

Të dhënat e tatimpaguesit

TRANSFERIM

Tipi dhe vlera e qarkulluar

Vlera për shkallë tatimore

Numri i pompës

Numri i identifikimit të regjistrusit elektronik fiskal

Data, ora

Numratori i kuponave tatimor

Logo fiskale

### 3.6 Raporti tatimor ditor "Z" në raste pa defekte

Emri i Tatimpaguesit	
Adresa	
Numri Niptit (ose logo grafike e tij)	
RAPORTI TATIMOR-DITOR Z	
-----	
19-05-2008	Ora : 15:45
KUPONI TATIMOR: 21	
	Z0020
SHITJE NORMALE	
KARBURANT TIPI 1	100 LT
10 shitje	*150,00
KARBURANT TIPI 2	100 LT
13 shitje	*160,00
KARBURANT TIPI 3	100 LT
5 shitje	*170,00
KARBURANT TIPI 4	100 LT
15 shitje:	*175,00
PARA NË DORË	
25	*500,00
PEZULL	
*200,00	
3	

Të dhënat e tatimpaguesit

Raporti Tatimor Ditor për shitjet e kryera në gjendje normale (Pa defekte) e cili përmban çdo veprim të kryer për: TEST+TRANSFERTA+FUÇI+IDENT.AUTO+SHITJE NORMALE

Detaje mbi shitjet për secilin tip të karburantit

Detaje mbi mënyrat e pagesës

KARTË KREDITI	14
*1000,00	
NUMRI I FURNIZIMEVE:	20
KUPONA TATIMOR:	21
KUPONA JO TATIMOR:	63
-----SHKALLA TATIMORE-----	
SHKALLA E TVSH C: %10	
TOTALE PA TVSH	* 350,00
TVSH %10	*20,00
TOTALE PËR SHKALLË	* 370,00
:	
SHKALLA E TVSH B: %20	
TOTALE PA TVSH	* 450,00
TVSH %10	*25,00
TOTALE PËR SHKALLË	* 475,00
-----	
TOTALE	
TOTAL PA TVSH	*800,00
TVSH	*123,54
TOTALE PËR SHKALLË	*923,54
*****	
TEST	
KARBURANT TIPI 1	2 LT
1 test	*10,00
KARBURANT TIPI 2	4 LT
3 test	*16,00
KARBURANT TIPI 3	6LT
2 test	*170,00
KARBURANT TIPI 4	8 LT
4 test	*70,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:	5
TOTALE TEST	*1000,00
TVSH TEST	*250,00
*****	
TRANSFERIM	
KARBURANT TIPI 1	2 LT
1 test	*10,00
KARBURANT TIPI 2	4 LT
3 test	*16,00
KARBURANT TIPI 3	6LT
2 test	*170,00
KARBURANT TIPI 4	8 LT
4 test	*70,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:5	
TOTALE TRANSFERIM	*1000,00
TVSH TRANSFERIM	*250,00
*****	
---TOTALE SHITJE NORMALE ---	
TOTALE	*800,00
TVSH	*123,54
TOTALE TEST	*100,00
TVSH TEST	*13,54
TOTAL TRANSFERIM	*100,00
TVSH TRANSFERIM	*13,54
--- TOTALE SHITJE ME DEFEKT ---	
TOTALE DEFEKT	*80,00
TVSH DEFEKT	*8,00

Detaje mbi shitjet për shkallë tatimore

Totale shitur pa periudhë defekti

Detaje mbi testet në stacion

Detaje mbi transferimet

Totalet



--- TOTALE E PËRGJITHSHME---

(NORMALE+DEFEKT)

TOT+DEFEKT	*880,00
TVSH+DEFEKT	*70,00
TOT+DEFEKT ID AUTO	*880,00
TAX+DEFEKT ID AUTO	*73,00

REGJ. ELEKTRONIK NR. XXXXXXXXXXXX



Numri i identifikimit të regjistruarit elektronik

Logo fiskale

### 3.7 Raporti tatimor ditor "Z" në rast defekti

Emri i Tatimpaguesit  
Adresa  
Numri Niptit  
(ose logo grafike e tij)

RAPORTI TATIMOR-DITOR Z

19-05-2008 Ora : 15:45  
KUPONI TATIMOR : 21

	Z0020	
SHITJE NORMALE		
KARBURANT TIPI 1	100 LT	
10 shitje	*150,00	
KARBURANT TIPI 2	100 LT	
13 shitje	*160,00	
KARBURANT TIPI 3	100 LT	
5 shitje	*170,00	
KARBURANT TIPI 4	100 LT	
15 shitje	*175,00	
:		
PARA NË DORË		
25	*500,00	
PEZULL		3
*200,00		
KARTË KREDITI		14
*1000,00		
NUMRI I FURNIZIMEVE:	20	
KUPONA TATIMOR:	21	
KUPONA JO TATIMOR:	63	

Të dhënat e tatimpaguesit

Raporti Tatimor Ditor për shitjet e kryera në gjendje normale (Pa defekte) e cili përmban çdo veprim të kryer për: TEST+TRANSFERTA+FUÇI+IDENT.AUTO+SHITJE NORMALE

Detaje mbi shitjet për secilin tip të karburantit

Detaje mbi mënyrat e pagesës

-----SHKALLA TATIMORE-----	
SHKALLA E TVSH C: %10	
TOTALE PA TVSH	* 350,00
TVSH %10	*20,00
TOTALE PËR SHKALLË	* 370,00
:	
SHKALLA E TVSH B: %20	
TOTALE PA TVSH	* 450,00
TVSH %10	*25,00
TOTALE PËR SHKALLË	* 475,00
-----	
TOTALE	
TOTAL PA TVSH	*800,00
TVSH	*123,54
TOTALE PËR SHKALLË	*923,54
*****	
TEST	
KARBURANT TIPI 1	2 LT
1 test	*10,00
KARBURANT TIPI 2	4 LT
3 test	*16,00
KARBURANT TIPI 3	6LT
2 test	*170,00
KARBURANT TIPI 4	8 LT
4 test	*70,00
NUMRI I FURNIZIMEVE: 5	
TOTALE TEST	*1000,00
TVSH TEST	*250,00
*****	
TRANSFERIM	
KARBURANT TIPI 1	2 LT
1 test	*10,00
KARBURANT TIPI 2	4 LT
3 test	*16,00
KARBURANT TIPI 3	6LT
2 test	*170,00
KARBURANT TIPI 4	8 LT
4 test	*70,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:5	
TOTALE TRANSFERIM	*1000,00
TVSH TRANSFERIM	*250,00
*****	
#####	
SHITJE ME DEFEKT	
DEFEKTI FILLOI:	19-08-08 10:45
DEFEKTI MBAROI:	19-08-08 12:30
DEFEKTI FILLOI:	19-08-08 13:45
DEFEKTI MBAROI:	19-08-08 15:30
DEFEKTI FILLOI:	19-08-08 16:45
DEFEKTI MBAROI:	19-08-08 17:30
KARBURANT TIPI 1	
2 Shitje	10 LT
	*15.000,00
KARBURANT TIPI 2	10 LT
2 Shitje	*16.000,00
KARBURANT TIPI 3	10 LT
3 Shitje	*17.000,00
KARBURANT TIPI 4	10 LT
3 Shitje	*17.500,00
NUMRI I FURNIZIMEVE:5	

Detaje mbi shitjet për shkallë tatimore

Totale shitur pa periudhë defekti

Detaje mbi testet në stacion

Detaje mbi transferimet

Detaje mbi defektet dhe koha kur regjistruesi elektronik ka pasur defekt

Detaje mbi shitjet pa kupon

-----  
 SHKALLA TVSH C: %10 \*35.000,00  
 TVSH C: %10 \*2.000,00  
 TOTALE PËR SHKALLË: \*37.000,00

SHKALLA TVSH B: %20 \*45.000,00  
 TVSH B: %20 \*5.000,00  
 TOTALE PËR SHKALLË \*50.000,00

-----  
 TOTALE DEFEKT \*80.000,00  
 TVSH DEFEKT \*7.000,00  
 TOTALE \*87.000,00

\*\*\*\*\*

DEFEKT - SHITJE ME ID. AUTO  
 KARBURANT TIPI 1 10 LT  
 2 Shitje \*15.000,00  
 KARBURANT TIPI 2 10 LT  
 2 Shitje \*16.000,00  
 KARBURANT TIPI 3 10 LT  
 3 Shitje \*17.000,00  
 KARBURANT TIPI 4 0 LT  
 3 Shitje 17.500,00

NUMRI I FURNIZIMEVE:5

TOTALE DEFEKT ID AUTO \*30.000,00  
 TVSH DEFEKT ID AUTO \*3.545,45  
 TOTALE \*33.545,45

#####

TOTALE E PËRGJITHSHME  
 (NORMAL + DEFEKTE)

KARBURANT TIPI 1 10 LT  
 2 Shitje \*15.000,00  
 KARBURANT TIPI 2 10 LT  
 2 Shitje \*16.000,00  
 KARBURANT TIPI 3 10 LT  
 3 Shitje \*17.000,00  
 KARBURANT TIPI 4 10 LT  
 3 Shitje \*17.500,00

NUMRI I FURNIZIMEVE:5

-----  
 SHKALLA TVSH C: %10 \*35.000,00  
 TVSH C: %10 \*2.000,00  
 TOTALE PËR SHKALLË: \*37.000,00

SHKALLA TVSH B: %20 \*45.000,00  
 TVSH B: %20 \*5.000,00  
 TOTALE PËR SHKALLË \*50.000,00

-----  
 TOTALE NORMAL+DEFEKT \*80.000,00  
 TVSH NORMAL+DEFEKT \*7.000,00  
 TOTALE \*87.000,00

\*\*\*\*\*

SHITJE E PËRGJITHSHME ME ID AUTO  
 (NORMAL + DEFEKT)

KARBURANT TIPI 1 10 LT  
 2 Shitje \*15.000,00  
 KARBURANT TIPI 2 10 LT  
 2 Shitje \*16.000,00  
 KARBURANT TIPI 3 10 LT  
 3 Shitje \*17.000,00


Totalet mbi shitjet në defekt për shkallë tatimore

Totalet

Detajet e shitjes me defekt të regjistruarit elektronik  
 mbi identifikimin e autonjetit

Totalet

Detaje mbi totalet e përgjithshme

KARBURANT TIPI 4	10 LT
3 Shitje	*17.500,00
NUMRI I FURNIZIMEVE: 5	
TOTALE NORMAL+DEFEKT	*80.000,00
TVSH NORMAL+DEFEKT	*7.000,00
TOTALE	*87.000,00
#####	
---TOTALE SHITJE NORMALE ---	
TOTALE	*80.000,00
TVSH	*7.000,00
TOTALE TEST	*1.000,00
TVSH TEST	*250,00
TOTAL TRANSFERIM	*1.000,00
TVSH TRANSFERIM	*250,00
---	
--- TOTALE SHITJE ME DEFEKT ---	
TOTALE DEFEKT	*80.000,00
TVSH DEFEKT	*7.000,00
---	
--- TOTALE E PËRGJITHSHME ---	
(NORMALE+DEFEKT)	
TOT+DEFEKT	*87.000,00
TVSH+DEFEKT	*7.000,00
TOT+DEFEKT ID AUTO	*87.000,00
TAX+DEFEKT ID AUTO	*7.000,00
REGJ. ELEKTRONIK NR. XXXXXXXXXXXX	
	

Numri i identifikimit të regjistruarit elektronik

Logo fiskale

### 3.8 Raportet e memories fiskale

Në rast kontrolli të inspektorëve tatimore, raportet periodike tatimore të lëshuara nga leximi i memories fiskale duhet të jenë të tipes:

- Nga raporti tatimor ditor i parë Z – në raportin tatimor ditor Z të fundit.
- Për dy raporte tatimore ditore Z.
- Ndërmjet dy raporteve tatimore ditore Z
- Ndërmjet një intervali të datave.
- Ndërmjet dy datave.

Raporti periodik i printuar përmban të gjitha të dhënat sipas tipit të përzgjedhje dhe këto të dhëna janë të detajuara sipas formës së raportit tatimor ditor të prezantuar në shembullin e mësipërm.

### 3.9 Transmetimi periodik dhe skedari i transmetimit

Raporti periodik që duhet të dërgohet nga pika e karburantit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve do të kryhet sipas procedurës së përshkruar më lart në këtë udhëzim.

Arkitektura e skedarit që do të transmetohet duhet të jetë e njëjtë me arkitekturën e paraqitur në këtë udhëzim.

## 4. ADMINISTRIMI I PROCESIT DHE DOKUMENTACIONIT TË PAJISJEVE FISKALE NGA DREJTORITË RAJONALE TATIMORE

4.1 Administrata tatimore është organi përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e procesit të instalimit dhe përdorimit të pajisjeve fiskale, për qëllimet e matjes së volumit të shitjes së mallrave e shërbimeve të realizuara nga tatimpaguesit.

4.2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore, janë koordinatorë dhe kontrolluese të ecurisë së procesit të implementimit të pajisjeve me memorie fiskale dhe administrojnë procesin e implementimit në përputhje me vendimit të Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionit për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale”.

4.3.Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe drejtoritë rajonale nën vartësinë e saj, krijojnë strukturat e nevojshme për administrimin dhe kontrollin e implementimit të procesit për instalimin e pajisjeve fiskale. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, krijohet sektori i pajisjeve fiskale, brenda Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit, e cila menaxhon procesin e krijimit dhe funksionimit të sistemit të integruar për transferimin periodik, automatik të deklarimeve financiare. Në drejtoritë rajonale tatimore ngrihen njësitë e administrimit të dosjeve të pajisjeve fiskale për çdo tatimpagues përdorues.

4.4.Strukturat e ngritura pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe drejtorive rajonale për administrimin e procesit, mbajnë të sistemuar gjithë dokumentacionin që i përket procesit të implementimit të pajisjeve fiskale në dosjet përkatëse të çdo tatimpaguesi. Ato bëjnë kujdes për mbështetjen e tatimpaguesve me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kohë dhe ofrojnë ndaj tatimpaguesve mbështetjen e nevojshme teknike, ligjore dhe procedurale për realizimin me sukses të procesit.

4.5.Organet tatimore organizojnë në mënyrë të programuar punën për implementimin e pajisjeve fiskale në vartësi të prioriteteve të Qeverisë bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave dhe realizojnë një proces transparent, të drejtë e të barabartë kontrolli dhe verifikimi, për të gjithë tatimpaguesit, në instalimin, përdorimin dhe kontrollin e pajisjeve fiskale.

4.6.Inspektorët tatimorë të sektorit të zbatimit, të ngarkuar me detyrën për administrimin dhe kontrollin e përdorimit të pajisjeve fiskale, në punën e tyre mbështesin plotësimin e kërkesave ligjore, akteve nënligjore dhe kërkesave të rregulloreve për këtë qëllim. Ata krijojnë kushtet normale që tatimpaguesit të kryejnë pa pengesa e ndërprerje aktivitetin e biznesit.

4.7.Inspektorët tatimorë trajnohen në mënyrë të vazhdueshme për njohjen sa më mirë të kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007, akteve të tjera nënligjore, si dhe të kërkesave të këtij udhëzimi.

4.8.Inspektorët tatimorë në punën e vazhdueshme për implementimin e sistemit të pajisjeve fiskale dhe funksionimit normal të tyre, krijojnë një bazë të dhënash që shërben për njohjen e situatës në terren, duke fokusuar vëmendjen në mënjanimin e rrezikut të shmangies ndaj realizimit të detyrës.

4.9.Inspektorët tatimorë bëjnë përpjekje për njohjen e mirë të gjithë dokumentacionit të miratuar, dokumentacioni i cili i bashkëngjitet këtij udhëzimi, dhe kërkojnë zbatimin rigoroz të procedurave për regjistrimin fillestar të pajisjeve fiskale, kontrollin e plotësimit të dokumentacionit, arkivimin e tij në dosjen e tatimpaguesit etj. Inspektorët tatimorë të ngarkuar me këtë detyrë kontrollojnë procesin e përdorimit korrekt të pajisjeve fiskale dhe mbajnë qëndrim ligjor ku vërejnë shkelje ndaj moslëshimit të kuponit tatimore nëpërmjet pajisjeve fiskale.

4.10.Inspektorët tatimorë ndihmojnë në kapërcimin e vështirësive që iu krijojnë tatimpaguesve në rastet kur pajisjet fiskale nuk funksionojnë dhe mbështesin tatimpaguesit nëpërmjet ndërhyrjes së tyre jo vetëm për eliminimin sa më parë të defekteve të pajisjeve fiskale, por edhe për mbështetjen me dokumentacionin e përcaktuar në këto raste. Ata

kontrollojnë me shpejtësi e saktësi plotësimin nga tatimpaguesit të formularëve përkatës dhe kërkojnë vazhdimin pa ndërprerje të procesit të lëshimit të faturave nga tatimpaguesit duke kryer në vend kontrole, por duke bashkëpunuar edhe me subjektet furnizuese të pajisjeve fiskale për mënjanimin sa më parë të defekteve.

4.11. Organet tatimore bëjnë përpjekje të vazhdueshme për trajnimin e tatimpaguesve për njohjen sa më mirë të pajisjeve fiskale, të legjislacionit detyrues për përdorimin e tyre, por edhe për masat që zbatohen në rastet e ndërprerjes së funksionit të pajisjeve fiskale për shkaqe të ndryshme. Ato punojnë në frymën e bashkëpunimit me tatimpaguesit për të shmangur keqkuptimet dhe për kuptimin e zbatimit korrekt të kërkesave ligjore.

4.12. Organet tatimore mbajnë në mënyrë të vazhdueshme kontakte me shoqëritë e licencuara nga Ministri i Financave për furnizimin e tatimpaguesve me pajisje fiskale dhe ndërhyjnë kurdoherë kur vërejnë neglizhenca nga ana e këtyre të fundit, neglizhenca të cilat dëmtojnë procesin dhe devijojnë nga detyrimet kontraktuale që kanë këto shoqëri, detyrime të cilat janë pjesë e licencimit.

4.13. Organi tatimor kontrollon furnizimin e tatimpaguesve me pajisje fiskale që ai të jetë sipas karakteristikave teknike të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, duke bashkëpunuar për këtë qëllim me Drejtorinë e Kalibrimit dhe Peshëmatjes, nëpërmjet kontroleve të përbashkëta të organizuara.

4.14. Fiskalizimi i pajisjeve fiskale kryhet në ambientet e shoqërive të licencuara (me përjashtim të pikave të karburanteve, për të cilat fiskalizimi kryhet në ambientet e pikës së karburantit) pas nënshkrimit të kontratës nga tatimpaguesit me këto shoqëri, pasi të jetë plotësuar saktë formulari për furnizimin me pajisje, kontrolli i saktësisë së të dhënave të plotësuar të formularit dhe vetëm pas këtij kontrolli kryhet fiskalizimi i pajisjes fiskale nëpërmjet nënshkrimit të formularit nga inspektori tatimor, shoqëria e licencuar dhe tatimpaguesi duke administruar edhe kopje të kontratës së lidhur ndërmjet tyre. Shoqëritë e autorizuar përveç kopjeve në letër të dokumentacionit përkatës duhet t'i dërgojnë të dhënat e formularëve të përdorur edhe në format elektronik. Të dhënat elektronike dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është përgjegjëse për mirëmbajtjen e formularëve që do të përdoren në procesin e implementimit të pajisjeve fiskale në Republikën e Shqipërisë dhe është e detyruar që të gjithë formularët (së bashku me sqarimet për plotësimin e tyre) t'i publikojë në format elektronik në faqen e saj të internetit.

4.16. Inspektori tatimor i ngarkuar me kontrollin e pajisjeve fiskale dhe lëshimin e kuponëve tatimorë kërkon që në ambientet ku funksionon pajisja fiskale të evidentohet e shkruar qartë për klientët detyrimi i tyre për tërheqjen e kuponit tatimor dhe ndëshkimi i tyre sipas ligjit për mostërheqje të kuponit.

4.17. Inspektorët tatimore kryejnë rregullisht kontrole për lëshimin e kuponëve tatimorë dhe mbajnë procesverbale kur konstatojnë shkelje duke vendosur në vend gjobën sipas përcaktimeve ligjore, për tatimpaguesit dhe për klientët shkelës të ligjit.

4.18. Organi tatimor sensibilizon opinionin publik në lidhje me domosdoshmërinë e marrjes së kuponit tatimor dhe masat ndëshkimore edhe për ta, në rastet e mosmarrjes së faturës. Organet tatimore emetojnë dhe shpërndajnë falas broshura e fletëpalosje për këtë qëllim, si dhe organizojnë biseda me grupe të komunitetit të biznesit, në televizion e masmedia. Ata propagandojnë raste të shkeljeve dhe masat ndëshkimore të marra ndaj tatimpaguesve të ndryshëm, sikurse evidentojnë edhe rastet pozitive të zbatimit të kësaj reforme.

## 5. PËRDORIMI I DËFTESAVE TATIMORE NË RASTET E MOSFUNKSIONIMIT TË PËRKOHSHËM TË PAJISJEVE FISKALE

Në rastet e mosfunksionimit të përkohshëm të pajisjeve fiskale, të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, tatimpagues9341

it janë të detyruar të përdorin dëftesën tatimore për çdo shitje me pakicë që realizojnë. Blloku me dëftesa tatimore do të furnizohet nga drejtoritë rajonale tatimore dhe do të jetë me numër serial. Pas riparimit të pajisjes fiskale, tatimpaguesi fillon menjëherë përdorimin e saj.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Ridvan Bode**